



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:

“Shkenca Politike”

Universiteti “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof.Dr. Merita Xhumari

Dr. Dorianë Pano

Korrik / 2024

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Bachelor në "Shkenca Politike"**

1	IAL aplikues:	Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave Politike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në "Shkenca Politike"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë e MASH nr. 1786 prot, datë 20.03./2007
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Vendim Senati Nr. 116, datë 14.06.2018 Miratuar me shkresë MASR nr. 7648/1 prot, datë 18.09.2018
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA nr.104, datë 05.06.2019
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite akademike / 6 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët	-
15	Diplomë e dyfishtë	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli i 6 (gjashtë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	v.a. 2020-2021 19 PAE / 3 PAK v.a 2021-2022 17 PAE / 2 PAK v.a 2022-2023 17 PAE / 4 PAK
18	Numri i studentëve:	v.a. 2020-2021 26 studentë v.a 2021-2022 31 studentë v.a 2022-2023 9 studentë
19	Komente / të tjera:	-



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politike”, i ofruar nga Departamenti i Shkencave Politike, Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, është hapur për herë të parë me Shkresë e MASH nr. 1786 prot, datë 20.03./2007.

Ky program studimi është riorganizuar për shkak të ndryshimeve në legjislacionin për arsimin e lartë, dhe përshtatjen e programit Bachelor në “Shkenca Politike”, me Vendim Senati Nr. 116, datë 14.06.2018, miratuar nga MASR me shkresën me Nr. 7648/1 Prot., datë 18.09.2018.

Programi i studimit është hartuar në përputhje me objektivat formuese përcaktuese, të përgjithshme apo specifike e duke mbajtur parasysh kërkesat për nivele cilësore bashkëkohore dhe në bashkëpunim me përfaqësues të tregut të punës në nivel kombëtar. Programi i studimit realizohet me 180 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike (6 semestra), në përfundim të të cilit lëshohet diplomë “Bachelor” në “Shkenca Politike”.

Cilësia e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të departamentit, garanton përvojën dhe kapacitetet e nevojshme për ofrimin e programit të studimit

Në këtë program studimi, zhvillimi dhe përcjellja e dijeve zhvillohet nëpërmjet një sërë disiplinash (formuese të përgjithshme, karakterizuese, integruese), me anë të së cilave synohet asimilimi i njohurive teorike dhe zhvillimi i mendimit kritik. Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike” i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës ka aplikuar nëpërmjet sistemit AMS për nisjen e procesit të vlerësimit të programit të studimit Bachelor në "Shkenca Politike" për herë të parë. Kjo procedure vlerësimi paraqet të gjithë ecurinë që ndiqet nga ASCAL/BA për procesin e vlerësimit në kuadër të akreditimit të programit të studimit. Grupi i Eksperteve të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga dy anëtarë: **Prof.Dr. Merita XHUMARI** dhe **Dr.Doriana PANO**, me mbështetjen e Koordinatorëve Teknikë të ASCAL, Z.Erjon XHAKO, dhe Znj.Alma ARAPI ngritur nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL). Në punën për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm (RVJ), grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Procesi i vlerësimit të jashtëm ka filluar në muajin Shkurt 2022, me dorëzimin nga ana e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, (UAMD) të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm (RVB) si dhe dosjes së vetëvlerësimit (DVV) me dokumentacionin mbështetës. Ekspertët u njohën me RVB dhe DVV nëpërmjet sistemit të menaxhimit elektronik AMS të ASCAL.

Procesi i vlerësimit paraqet të gjithë ecurinë e punës që nga shqyrtimi i dokumentacionit deri në Raportin e dorëzuar në ASCAL në kuadër të kreditimit të programit të studimit Bachelor në "Shkenca Politike". Gjithë procesi është kryer në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në përputhje me "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit, 2017". Nisja e procedurës së vlerësimit të programit Bachelor në "Shkenca Politike", lidhet me shqyrtimin e dokumentacionit të derguar nga UAMD nëpërmjet shërbimit në AMS. Mbi bazën e një axhende të përcaktuar nga ASCAL në bashkëpunim me UAMD, në datat 20 dhe 21 Qershor 2023, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vizitoi institucionin dhe realizoi një sërë takimesh e intervistash me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, Përgjegjës të Departamentit të Shkencave Politike, me Grupin e vetëvlerësimit të programit, me Zyrën e Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë, me përfaqësues të Zyrës së Karrierës, Alumnit dhe Komunikimit, me stafin akademik të programit të studimit, dhe me studentët e programit të studimit. Gjithashtu GVJ, zhvilloi vizita në Sekretarinë Mësimore, në Sektorin e Burimeve Njerëzore, në Bibliotekë si dhe u njoh me mjediset e zhvillimit të procesit mësimor. Raporti i përgatitur përmbledh rezultatet e shqyrtimit të dokumentacionit të DVV, si dhe të informacionit të mbledhur gjatë vizitës në Institucion, apo dokumenteve shtesë.

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.05.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 19 / 86 Prot, datë 27.05.2024.", Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës njofton në ASCAL ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1

Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës (UAMD), veprimtarinë e tij e bazon në Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në aktet e tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, të Statutit të Universitetit. (Evidencë 1_Statuti UAMD). Fakulteti i Shkencave Politike Juridike, (FSHPJ), pjesë e këtij institucioni, ofron programe studimi, të cilat reflektojnë interesat kombëtare. Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkenca Politike” kontribuon në përgatitjen e specialistëve të cilët me kompetencat e tyre, do të punojnë për zhvillimin e modernizimin e vendit. Në qëllimet strategjike të UAMD përcaktohet ndër të tjera (Evidencë 2. fq. 5; 6_Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD-së 2020-2025). Ky program është në harmonizim të plotë me vlerat kulturore të kombit, duke ofruar kompetenca në Shkenca Politike kjo në përputhje me etikën profesionale dhe qytetare, dhe në të njëjtën linjë me interesat kombëtare, duke mos dëmтуar në asnjë formë ato.
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i Studimit Bachelor në “Shkenca Politike” është mbështetur dhe hartuar në përputhje me misionin e UAMD për të përgatitur profesionistë e qytetarë aktivë për shoqërinë demokratike shqiptare dhe për vlerat europiane. (Evidencë 1. Neni 3, fq.2_Statuti i UAMD-së). Në hartimin e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike” synohet të formohen studentë me dije, aftësi dhe kompetenca profesionale, nëpërmjet mësimdhënies, aftësimit për përdorimin e arritjeve më të mira të teorisë, praktikës dhe shkencës, mbështetur dhe hartuar në përputhje me misionin e UAMD-së. Fusha e studimit në Shkenca Politike, ka rëndësi të veçantë pasi formon profesionistë të aftë për të mbuluar fusha si media, specialistë në marrëdhëniet me publikun, këshilltar politik, këkues shkencor, duke pasuruar më tej profilin e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike . (Evidencë 5, Kreu II, Neni 5, Rregullore e Programit të Studimit Shkenca Politike; Evidencë 1, Statuti i UAMD)

<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.</p>	<p>Në planin strategjik të UAMD, për programet studimore, përcaktohen qartë objektivat e përfshirjes dhe angazhimit qytetar, zhvillimi i programeve të studimit në përgjigje të kërkesave të tregut të punës, përsosmëria në mësimdhënie, zhvillimi i kërkimeve shkencore në dobi të shoqërisë etj. (Evidencë 2_Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025). (Takimet në institucion me aktorë të ndryshëm)</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvijën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Sipas RVB-së dhe të dhënave tabelore, pjesë e DVV, në programin e studimit bachelor në “Shkenca Politike” në vitin akademik 2020-2021, janë angazhuar 19 PAE (3 Kategoria ‘Profesor’, 15 ‘Doktor’ dhe 1 Msc), 1 personel ndihmës-akademik dhe 3 PAK. Në vitin akademik 2021-2022, janë angazhuar 17 PAE (4 Kategoria ‘Profesor’ dhe 13 ‘Doktor’, 1 personel ndihmës-akademik dhe 2 PAK. Në vitin akademik 2022-2023, në nivel njësie bazë, janë angazhuar 17 PAE (5 Kategoria ‘Profesor’ dhe 12 ‘Doktor’), 1 personel ndihmës-akademik dhe 4 PAK.</p> <p><i>(Evidencë 15;16_Personeli akademik i angazhuar në FSHJP dhe SHP; Evidencë Tabela ASCAL SHP- Të dhëna përmbledhëse për personelin akademik dhe ndihmës akademik; Evidencë 13_CV e stafit akademik dhe ndihmës-akademik të programit të studimit.</i></p>
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>GVJ konstaton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit “Shkenca Politike” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë (Departamenti i Shkencave Politike) përgjegjës për këtë program. Ky program studimi është hartuar sipas Legjislacionit në fuqi dhe Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS), dhe është i regjistruar si program i Ciklit të I-rë Bachelor, niveli 6 i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve dhe në mbështetje të Ligjin Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin Shkencor në IAL-të në Republikën e Shqipërisë, Udhëzimi Nr 31, datë 15.11.2022 ka bërë dhe kodifikimin e këtij programi studimi. Sipas ISCED, klasifikimit ndërkombëtar të fushave të edukimit, Shkencat Politike aktualisht nuk ndodhen në të njëjtin klasifikim me ato Juridike, të parat i takojnë Kategorisë 3. Shkenca Sociale, të dytat Kategorisë 4. Administrim Biznesi dhe Jurisprudencë. UAMD mund ta rishikojë organizimin e Fakultetit duke ia bashkangjitur juridikun fakultetit të Biznesit.</p> <p><i>(Evidencë 1 Statuti UAMD; Evidencë 5 Rregullore e programit të studimit; Evidencë 22_Kodifikimi i programit të studimit UAMD)</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nisur nga të dhënat sa më lart, GVJ, konstatoi se programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike” është hartuar dhe zbatuar në përputhje me misionin dhe qëllimin e UAMD-së, aktet normative të tij si dhe aktet ligjore dhe nën ligjore në fuqi si dhe</i></p>

	<p>përshatatet më së miri me nevojat e tregut të punës për profesionistë në këtë fushë. Programi zbatohet në përputhje me Strategjinë e UAMD-së 2020-2025. Programi është në përputhje të plotë me ligjet në fuqi dhe legjislacionin zbatues, Kartën e Bolonjës dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve dhe synon të ruajë dhe promovojë vlerat njerëzore, vlerat kulturore dhe interesat kombëtare. Cilësia e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të departamentit, garanton përvojën dhe kapacitetet e nevojshme për ofrimin e programit të studimit. Grupi i vlerësimit të jashtëm (GVJ) diskutoi në mënyrë të hollësishme përputhshmërinë me kërkesat e përfshira në kriteret e përcaktuara më lart.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Administrimi i programit të studimit Bsc “Shkenca Politike” realizohet nga Departamenti i Shkencave Politike, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, mbështetur në aktet rregullatore të njësive përgjegjëse të programit të studimit (Evidencë 5_Rregullore e programit të studimit; Evidencë 4_Rregullore e FSHPJ) si dhe gjithë aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Angazhimi i personelit akademik nga fakultete të tjera të UAMD-së, si dhe angazhimi i personelit akademik me kontratë bazohet në marrjen e përgjegjësive respektive dhe vlerësimin e vazhdueshëm të punës së tyre.</p> <p><i>(Evidencë 26_Analizë e DSHP; Evidencë 45_Raport Vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore dhe financiare; Takime në institucion me staf drejtues dhe personel akademik).</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe</p>	<p>Për realizimin e objektivave të programit të studimit UAMD ka hartuar “Strategjinë e Ndërkombëtarizimit 2019-2021” në nivel institucional, ku lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe projekteve të cilat impaktojnë edhe këtë program studimi, zhvillohet në kuadër institucional. <i>(Evidencë 2_Plani I zhvillimit strategjik të UAMD-së 2020-2025, fq.5).</i> UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh homologe vendase si</p>

brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	<p>Bashki, Njësitë Bashkiake, Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë, Institucioni i Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Akademia e Forcave të Armatosura, Akademia e studimeve Albanologjike, KLSH, disa universitete kombëtare dhe ndërkombëtare etj.</p> <p><i>(Evidencë 37_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit UAMD)</i></p>			
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	<p>UAMD ka marrëdhënie zyrtare me Institucione publike dhe ato private, për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës mësimore <i>(Evidencë 37_Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit UAMD)</i>. Zhvillimi i praktikës kryhet duke iu referuar rregullores përkatëse dhe përfundon me një raport të praktikës profesionale.</p> <p><i>(Evidencë 5, Neni 34_Rregullore e programit të studimit; shtojca 1,2, 3 po aty Paketa e praktikës për programin e studimit bachelor SHP).</i></p>			
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	<p>Referuar DVV-së, takimeve në institucion dhe RVB, rezulton se vetëm në vitin akademik 2020-2021, UAMD ka hartuar një raport analitik vjetor të veprimtarisë mësimore ku jepen dhe përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p> <p><i>(Evidencë 45_Raport Vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore dhe financiare 2020-2021) (Takime në institucion).</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ nga të dhënat e paraqitura në RVB dhe DVV lidhur me realizimin e objektivave të programit të studimit konstaton se institucioni ka hartuar strategjinë e ndërkombëtarizimit në nivel institucional, ku lidhja e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe projekteve të cilat impaktojnë edhe këtë program studimi, zhvillohet në kuadër institucional. Kjo do të ndikojë pozitivisht në forcimin e këtij programi studimi dhe nxjerrjen e brezave të kualifikuar në këtë drejtim. Suksesi do të kërkojë sigurisht një punë intensive dhe përpjekje jo të vogla, por që potencialisht ekziston mundësia e rritjes në vitet akademike në vazhdim.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Politike" është i organizuar në lëndë dhe module të cilat kanë nga 5-10 kredite ECTS të vlerësuara në <i>(Evidencë 24_Plani mësimor i programit të studimit)</i>, në përputhje me legjislacionin në fuqi (VKM Nr. 41 datë 21.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar). Programi i studimit Bachelor në "Shkenca Politike" është i organizuar në 6 semestra me module lëndësh, përfshi një pjesë të semestrit të dytë të vitit të 3-të, që i kushtohet përgatitjes së Detyrimit final (provim me shkrim ose mikro-tezës) si edhe kryerjes së praktikës mësimore në institucione publike ose private. Modulet e lëndës vlerësohen sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kjo ndarje ofron fleksibilitet në transferimin e krediteve dhe mobilitetin e studentëve, ndërsa punimi i diplomës/provimi i përgjithshëm përfundimtar janë të vlerësuara me 6 kredite. Totali i krediteve që studenti duhet të marrë për t'u diplomuar është 180 ECTS.</p> <p><i>(Evidence 5_Rregullore e programit të studimit; Evidencë 24_Plani mësimor i programit të studimit SHP).</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve</p>	<p>Programi bachelor në "Shkenca Politike" ofron mundësinë e zhvillimit të aftësive dhe kompetencave në fushën e shkencave politike, të përshtatshme për një program të ciklit të parë. Ndërthurja e komponentëve teorikë me ato praktikë, mundëson pajisjen e studentëve me aftësi për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e shkencave politike <i>(Evidencë 24_Plani mësimor i programit të studimit; Evidencë 12_Syllabuset e lëndëve)</i>. Programi ndërthur njohuritë e përgjithshme, të përcaktuara në Kategorinë A (të tilla si: Hyrje në Shkenca Politike, Hyrje në ekonomi, Historia e Shqipërisë, Shkrim akademik), me njohuritë specifike të lidhura me fushën e studimit, të përcaktuara në Kategorinë B (të tilla si: Filozofi politike, Teoritë e Demokracisë, Mendimi politik, Historia e sistemeve të qeverisjes, Organizatat ndërkombëtare, Administrim Publik etj) <i>(Evidencë 24_Plani mësimor i programit të studimit)</i>. Njohuritë</p>

<p>komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>teorike të përfituara nga kombinimi i lëndëve në Kategorinë A dhe B, së bashku me orët individuale të studimit dhe praktikën mësimore, ndikon në zhvillimin e njohurive dhe kompetencave për studentët e këtij programi, duke i bërë ata të aftë të kenë aftësitë e nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse në fushën e shkencave politike.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i studimit i ka të përcaktuara qartë veprimtaritë formuese, duke i grupuar lëndët/modulet sipas kategorive dhe me ngarkesën përkatëse të shprehur në kredite ECTS (<i>Evidencë 24_Plani mësimor i programit të studimit SHP</i>). Programi është i organizuar në tre vite akademike (180 ECTS), 6 semestra.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A, ka një ngarkesë prej 34 ECTS (18.89%) dhe ka të grupuara lëndë për përgatitje metodologjike dhe lëndë për kulturë të përgjithshme. • Në kategorinë B, e cila ka një ngarkesë prej 96 ECTS (53.34%), janë të grupuara lëndët për përgatitjen për disiplinën e shkencave politike. • Kategoria C, me një ngarkesë prej 22 ECTS (12.22%), grupon lëndë ndërdisiplinore. • Kategoria D, me një ngarkesë prej 22 ECTS (12.22%), përfshin lëndët plotësuese. • Kategoria E përfshin detyrimin përmbyllës, provim formimi/Diplomë dhe ka një ngarkesë prej 6 ECTS (3.33%)
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Programi është i organizuar sipas Kategorive A-E, me përmbajtje sipas parashikimeve ligjore për natyrën e lëndëve në secilën kategori, sikurse dhe praktikën dhe detyrimet përmbyllëse (punim diplome/provim), të cilat i përkasin kategorive D dhe E (6 ECTS secila).</p> <p>(<i>Evidencë 24_Plani mësimor i programit të studimit SHP</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>UAMD si një institucion i arsimit të lartë publik në RSH nuk ka një status të veçantë. Si i tillë ky kriter nuk aplikohet për këtë program studimi.</p> <p>(Ligji-80-2015_22.07.2015)</p>

<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Nisur nga përmbajtja e këtij program studimi si dhe evidentimi i gjetur në linkun në evidencat e RVB-së, gjejmë përputhshmëri deri në masën 70 % me programin bachelor në Shkenca Politike të Universitetit të Tiranës (https://fshs-ut.edu.al/?page_id=234). Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, lëndët dhe ngarkesa e tyre, është në përputhje me një program studimi të ciklit të parë në fushën e shkencave politike (<i>Evidencë 24 Plani mësimor i programit të studimit</i>), dhe përmban lëndë të përgjithshme dhe karakterizuese të përafërt me programe të ngjashme (kryesisht lëndët teorike), por të ndërthurura dhe me lëndë të cilat lidhen me kontekstin e Shqipërisë, të tilla si Sistemet Politike në Shqipëri, Politika dhe Demokracia në EJL, etj.</p>
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Në dokumentacionin e paraqitur në DVV dhe në takimin që u zhvillua në institucion me drejtuesin e njësisë kryesore dhe njësisë bazë na u sqarua se lidhur me kodifikimin e programit të studimit bachelor në “Shkenca Politike”, janë në pritje të unifikimit nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, gjithësesi ata kanë hartuar një kodifikim të brendshëm të programeve të studimit e konkretisht për programin bachelor në Shkenca Politike është përcaktuar kodi S63BA0312.</p> <p><i>(Evidencë 22_Kodifikimi i Programeve UAMD, programi 50)</i></p>
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>N/A</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ, pas shqyrtimit të DVV dhe takimeve në institucion, lidhur me këtë standard del në përfundimin se programi Bachelor në “Shkenca Politike” është plotësisht në përputhje me standardet dhe kriteret e kërkuara nga aktet ligjore të Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje me misionin dhe qëllimet e UAMD si edhe me Strategjinë për Zhvillim të Institucionit. Ky program studimi organizohet në module lëndësh të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe shuma mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë 1 v.a nga një student i cili ndjek një këtë program studimi është 60 ECTS. GVJ arrin në përfundimin se programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike” është plotësisht në përputhje me standardet dhe kriteret e kërkuara. Ky program studimi siguron menaxhim efikas të informacionit në lidhje me programin e studimit, dhe u ofron</i></p>

	<i>studentëve të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programeve të studimit, lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër, ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën mësimore etj. Informacioni në fjalë jepet në format të lehtë dhe të kuptueshëm, si dhe lehtësisht të aksesueshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Programi i studimit Shkenca Politike ofrohet nga Departamenti i Shkencave Politike, njësi bazë e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, i cili ka në përbërjen e tij edhe 2 Departamente të tjerë, respektivisht Departamenti i Drejtësisë dhe Departamenti i Administrimit Publik. Struktura akademike mbështetet dhe nga struktura administrative, ndër njësitë kryesore të së cilës janë Sigurimi i Brendshëm i Cilësisë, strukturat e teknologjisë së informacionit, struktura e kurrikulave, Shërbimet për Studentët dhe Projektet, Sekretaria Mësimore, Biblioteka, Zyra e Burimeve Njerëzore , etj. (Evidencë 1_Statuti i UAMD- Neni 24).</p> <p>Organizimi dhe struktura akademike e njësisë kryesore dhe njësisë bazë, është konform parashikimeve ligjore në fuqi, dhe funksionojnë në bazë të akteve të brendshme rregullatore (Evidencë 1_Statuti i UAMD; Evidencë 4_Rregullore UAMD; Evidencë 5_Rregullore e programit të studimit; Evidencë _15, 16, Personel akademik në FSHPJ dhe SHP)</p> <p>Departamenti i Shkencave Politike si njësi bazë, në bashkëpunim edhe me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), kryejnë vlerësimin e brendshëm periodik për rezultatet dhe nivelin cilësor të aktiviteteve formuese, sipas modaliteteve të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore (Evidencë 1_Statuti UAMD Neni 41; Evidencë 6_Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm për sigurimin e cilësisë në UAMD; Evidencë 10_Vendim i FSHPJ për ngritjen e NJSC). Lidhur me procesin e vlerësimit të jashtëm, institucioni i është nënshtruar procesit periodik të vlerësimit të jashtëm, akreditimit (Evidencë</p>

IXXX_Certifikatë Akreditimi), ndërsa programi i studimit po i nënshtrohet për herë të parë këtij procesi.

Tituj/grada	2020-2021		2021-2022		2022 – 2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-	3	1	2	1	1
Prof.As.Dr	4	-	3	-	4	-
Dr/PhD	14	13	14	8	13	4
Msc		2		1	-	-
Në total	18	18	18	11	18	5

Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.

Institucioni angazhon personel akademik, personel ndihmës akademik me karakter mësimor, që ndihmon në realizimin e veprimtarisë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe personel me karakter administrativ, që ndihmon në realizimin e veprimtarive të mësimdhënies. Në këtë kontekst personeli akademik dhe ai ndihmës njihen me detyrat dhe të drejtat nëpërmjet kontratës së punës. FSHPJ, ku bën pjesë Departamenti i Shkencave Politike ka në përbërjen e saj një personel akademik ndihmës, i cili mbështet këtë njësi në realizimin e proceseve akademike dhe administrative. *(Evidencë 15,16_Personeli akademik i angazhuar në FSHPJ, DSHP).*

Studentët përfitojnë nga mjediset e përshtatshme, si laboratorit informatikës dhe biblioteka. Sipas kërkesës së pedagogut të lëndës, për të realizuar një mësimdhënie më efektive dhe për të asistuar studentët, universiteti ka instaluar një gamë të gjerë programesh hardëare dhe softëare. Për qëllime kërkimore apo projekte studimore, studentët mund të përdorin infrastrukturën elektronike që institucioni disponon.

Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.

Departamenti ka caktuar një koordinator (Dr. D. B) për programin Bachelor në “Shkenca Politike” *(Evidencë 23_Vendim për emërimin e Koordinatorit të Programit të Studimit)*. Koordinatorit të studimit mbështet planifikimin, koordinon dhe mbikëqyr veprimtarinë e programit të studimit, për të siguruar përmbushjen e misionit dhe objektivave të programit. Detyrat dhe përgjegjësitë specifike të tij, janë të parashikuara në aktet e brendshme rregullatore *(Evidencë 5, Neni 8. Rregullore e programit të studimit Shkenca Politike- Detyrat e organeve drejtuese-Përshkrimi i detyrave të Koordinatorit të Programit të Studimit)*. Ndër detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Koordinatorit të Programit janë:

- mbikëqyr respektimin e programeve të mësimdhënies në kohën

	<p>e caktuar</p> <ul style="list-style-type: none"> • harton strategjinë e zhvillimit të programit të studimit SHP • propozon ndryshime në planin mësimor të cilat më pas i paraqet për diskutim në Asamblenë e personelit akademik të njësisë bazë • ruan komunikimin e vazhdueshëm me studentët e këtij programi studimi dhe përcjell çdo problematikë të tyre në autoritetet drejtuese të FSHPJ dhe DSHP • organizon analizën vjetore të programit të studimit • raporton tek përgjegjësi i departamentit për mbarëvajtjen dhe problematikat e hasura në lidhje me këtë program. 			
Konkluzione	<p><i>Nisur nga sa më lart, GVJ, vëren një impenjim serioz dhe transparent për të ndërtuar një sistem të përzgjedhjes dhe angazhimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrati mbi bazën e korrektësisë, transparencës, meritokracisë dhe cilësisë së zhvillimit të programit të studimit. Për këtë program studimi, departamenti zotëron një personel akademik dhe administrativ të kualifikuar. Anëtarët e personelit akademik kanë eksperiencën e nevojshme akademike dhe janë autorë të disa botimeve shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, në fushat përkatëse me interes për to. Në përmbushjen e objektivave të studimit të ciklit të parë shihet një angazhim maksimal i burimeve njerëzore, por edhe një shfrytëzim optimal i burimeve të ndryshme të informacionit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga institucioni, konfirmuar edhe gjatë vizitës dhe takimeve të zhvilluara në institucion, konstatohet se njësia përgjegjëse, disponon informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit bachelor "Shkenca Politike". Drejtuesi i Departamentit njëherazi dhe Koordinatore e Programit, në bashkëpunim edhe me Dekanin, grumbullojnë dhe analizojnë informacionin e plotë mbi programin, i cili u shërben për të marrë

<p>programeve të studimeve.</p>	<p>edhe masa në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të programit të studimit.</p> <p><i>(Evidencë 1_Statuti i UAMD; Evidencë 4_Rregullore e UAMD; Evidencë 5_Rregullore e Programit SHP; Evidencë 26_Analizë vjetore e punës së DSHP; Evidencë 36_Raport Vjetor të FSHPJ).</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit bachelor në “Shkenca Politike” është i organizuar në lëndë/module, praktikë dhe aktivitete formuese, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi (Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; VKM Nr.41 datë 21.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, i ndryshuar). Programi është i organizuar sipas Kategorive A-E, me përmbajtje sipas parashikimeve ligjore për natyrën e lëndëve në secilin kategori, sikurse dhe praktikën dhe detyrimet përmbyllëse (punim diplome/provim), me kohëzgjatje 3 vite akademike, 6 semestra, dhe me një ngarkesë prej 180 ECTS (me një shpërndarje të balancuar prej 60 ECTS në secilin vit akademik).</p> <p>Të gjitha lëndët/modulet, sikurse dhe detyrimet e tjera të programit të studimit, të tilla si praktika mësimore dhe detyrimet përmbyllëse (diplomimi), janë të vlerësuara me kredite ECTS, të ndara në 3 vite akademike dhe 6 semestra. Shpërndarja e ngarkesës mësimore ndër vite është e balancuar, sikurse dhe strukturimi i lëndëve, duke nisur me lëndë të karakterit të përgjithshëm në vitin e parë, e deri tek Praktika Mësimore dhe Detyrimet Përmbyllëse në semestrin e fundit, vlerësohen si të përshtatshme.</p> <p><i>(Evidencë 24_Plani mësimor i programit të studimit SHP).</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informacioni i nevojshëm që lidhet me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve, është i përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore <i>(Evidencë 4_Rregullore e UAMD, Neni 44, Pranimi në Programet e ciklit të parë të studimeve dhe planifikimi i kuotave, Evidencë 5 Neni 10, 11_Rregullore e Programit të Studimit)</i>. Për vetë natyrën e fushës së programit të studimit, fusha e shkencave politike, kriteret e pranimit janë vetëm ato të përgjithshme dhe nuk ka kriteret specifike <i>(Evidencë 30_Vendim Senati për miratimin e kuotave të pranimit; Evidencë 27_Vendim Senati për miratimin e kriterëve të pranimit të studentëve)</i>. Kandidati që dëshiron të ndjekë programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike” duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të ketë përfunduar me sukses maturën shtetërore dhe të zotërojë Dëftesën e Pjekurisë; • të ketë dhënë provimet e Maturës Shtetërore;

	<ul style="list-style-type: none"> • të përbushë kriterin e mesatares.
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikatat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Plani mësimor i detajuar, është pjesë integrale e Rregullores së Programit (<i>Evidencë 5_Rregullore e Programit të Studimit</i>). Në planin mësimor përfshihet informacioni i nevojshëm për lëndët/modulet, viti dhe semestri kur ofrohet lënda/moduli, ngarkesën mësimore, leksionet, seminarët, ushtrimet, orët në auditor dhe jashtë tij. Mënyra e vlerësimit të dijeve përcaktohet në Rregulloren e Programit, sikurse dhe syllabuset e lëndëve. (<i>Evidencë 5_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 12_Syllabuset e lëndëve SHP</i>). Programi i studimit ka në total 30 lëndë/module të detyrueshme, 5 grup lëndësh me zgjedhje, praktikën dhe detyrimin përmbyllës (punim diplome/provim), të ndara në kategori A-E. (<i>Evidencë 24_Plani mësimor i programit të studimit</i>). Ngarkesa totale e programit të studimit është 180 ECTS (4500 orë në total, prej të cilave 1485 orë në auditor/ 3015 orë studim individual/ prej të cilave 45 orë praktikë), me një shpërndarje prej 60 ECTS/1500 orë, në secilin vit akademik. Në vitin e I, programi ka të parashikuar 495 orë në auditor dhe 1005 orë studim individual, në vitin e II ky raport është 540 orë në auditor/ 960 orë studim individual ndërsa në vitin e III, 450 orë në auditor/ 1005 orën studim individual/ 45 orë praktikë. Në planin mësimor detajohen orët për leksionet/ seminarët/ ushtrimet/ laboratorët/ detyrat, si në auditor ashtu edhe orët e studimit individual. Frekuentimi është i detyrueshëm për të gjitha lëndët mësimore dhe praktikën mësimore në masën 75%. Mungesa në seminare dhe praktikë është e pranuar deri në masën 25% (<i>Evidencë 5_Rregullore e Programit të Studimit</i>). Vlerësimi në një lëndë bëhet:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Provimi i ndërmjetëm (40%) 2. Provimi përfundimtar (50%) 3. Projektet / detyrat e kursit (10%) <p>Në syllabuset e lëndëve janë të përcaktuara format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe pesha specifike në përqindje e secilit prej komponentëve të vlerësimit.</p> <p>(<i>Evidencë 12_Syllabuset e lëndëve SHP</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe</p>	<p>Përmirësimi dhe përditësimi i programit të studimit, është një proces i cili evidentohet dhe i takon personelit akademik të këtij programi studimi, të cilët në liri të plotë akademike rekomandimet e të cilëve më pas propozohen dhe miratohen në departament përpara fillimit të vitit akademik. Këto ndryshime lidhen si me përditësimin e syllabuseve ashtu edhe me përditësimin e programit të studimit në tërësi. Propozimi përcillet në Dekanat.</p>

arkivohet dosja e plotë.	
Konkluzione	<i>GVJ pas mbledhjes dhe vlerësimit të të gjithë informacionit del në konkluzionin se programi Bachelor në "Shkenca Politike" siguron një informacion të plotë për studentët në lidhje me programin e studimit dhe u ofron atyre të gjithë informacionin e nevojshëm për përmbajtjen e programit të studimit, lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër, ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikën mësimore etj.</i>
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet
	Përmbushet pjesërisht
	Përmbushet kryesisht
	Përmbushet plotësisht
	X

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Emërtimi i programit të studimit "Shkenca Politike" vlerësohet si i përshtatshëm në funksion të përmbajtjes, objektivave formues por edhe mundësive të punësimit apo vijimit të studimeve në ciklet pasardhëse. Kombinimi i komponentëve teorik me ato praktik, vlerësohet i përshtatshëm, duke qenë se në semestrat e parë studentët pajisen me njohuri të formimit të përgjithshëm dhe karakterizues të disiplinës përkatëse, për të vijuar në vitin e fundit me praktikën mësimore dhe detyrimet përmbyllëse. <i>(Evidencë 24_Plani mësimor i programit të studimit)</i> . Shpërndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese në: lëndë bazë, lëndë karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe përmbyllëse ndihmon studentët të fitojnë njohuri, të përmirësojnë aftësitë dhe të rrisin mundësitë e punësimit të tyre në institucione publike, si kërkues i shkencave politike, staf në fushata elektorale, analist tregu, gazetar ose korrespondent politik organizata ndërkombëtare, OJF, etj.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe	Vlerësohet se struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit <i>(Evidencë 24_Plani mësimor i programit të studimit)</i> , mundëson arritjen e objektivave të përgjithshme dhe objektivave specifik të programit të ciklit të parë, bachelor "Shkenca Politike", të përcaktuar në aktet e brendshme rregullatore <i>(Evidencë 5_Rregullore e Programit të Studimit)</i> duke bërë të mundur në këtë mënyrë që në përfundim të studimeve studentët të jenë

<p>rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>profesionistë të aftë për të realizuar analiza politike, të zotërojnë koncepte, dije dhe njohuri të plota mbi teoritë politike, qeverisjes dhe politikave publike, si dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të jenë të aftë ta orientojnë karrierën e tyre në shërbim të interesave më të larta dhe të parimeve demokratike të shoqërisë.</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Struktura dhe përmbajtja e programit të studimit, lëndët dhe ngarkesa e tyre, është në përputhje me një program studimi të ciklit të parë në fushën e shkencave politike (<i>Evidencë 24_Plani mësimor i programit të studimit</i>), dhe përmban lëndë të përgjithshme dhe karakterizuese të përafërt me programe të ngjashme.</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit, sikurse dhe përmbajtja e tij, mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferimin e studimeve dhe mobilitetin e studentëve (për shkak të ngjashmërisë me programe të ofruara nga IAL të tjera), sikurse dhe punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve (duke qenë se i pajis me njohuri dhe kompetenca të përshtatshme), ose për të vijuar në programet e studimit të ciklit të dytë.</p> <p>Gjatë vitit të I-rë studentit i mundësohet njohuria mbi strukturën e disiplinës e cila merret nëpërmjet lëndëve si “Hyrje në Shkencat Politike”, “Politikat Krahasuese” apo “Filozofi Politike” i mundësohet integrimi gradual me ambjentin universitar, metodologjinë e mësimdhënies etj. Gjatë vitit të dytë studenti frekuenton lëndë karakterizuese profesionale për të përfutur bazat e nevojshme teorike edhe praktike për formimin e tyre profesional. Objektivi i lëndëve të vitit të dytë është që t’i ofroj studentëve njohuritë e nevojshme karakterizuese profesionale duke i prezantuar ata me teoritë e demokracisë, partitë politike, organizatat dhe marrëdhëniet ndërkombëtare, administrim publik etj. Gjatë vitit të tretë studimet e tyre orientojnë më së shumti drejt lëndëve karakterizuese e të thelluara. Në semestër të dytë ata zhvillojnë praktikën profesionale dhe provimin final (Diplomimi)</p> <p><i>(Evidencë 5_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 24_Plani mësimor i programit të studimit</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë</p>	<p>Përditësimi i programeve të lëndëve/moduleve, si një ndër komponentët e përmirësimit të vazhdueshëm që duhet të realizohen në programet e studimit është një proces periodik i cili iniciohet kryesisht nga titullarët e lëndëve. Nga shqyrtimi i syllabuseve, konstatohet se ky kriter nuk përmbushet plotësisht. (<i>Evidencë 12_Syllabuset e lëndëve SHP</i>).</p> <p><i>Ky element u diskutua edhe gjatë takimeve të zhvilluara në</i></p>

dhe ndihmëse të viteve të fundit.	<i>institucion dhe argumenti kryesor i dhënë nga stafi akademik, lidhet me mungesën e teksteve të viteve të fundit, të përkthyer në gjuhën shqipe, dhe kjo mangësi tejkalohet nëpërmjet materialeve narrative të përgatitura nga ana e personelit akademik dhe që i vihen në dispozicion studentëve.</i>
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	<p>Përmbajtja e programit të studimit, për shkak të mënyrës së organizimit (sipas Kategorive A-E, raporti midis komponentëve teorik dhe atyre praktik), garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara, për studentët që përfundojnë një program studimi të ciklit të parë, në fushën e shkencave politike (<i>Evidencë 5_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 24_Plani mësimor i programit të studimit</i>). Njohuritë teorike ndërthuren me aspektet praktike, pjesë e seminareve, projekteve, detyrave të kursit dhe prezantimeve dhe praktika mësimore, të cilat shërbejnë për të formuar kuadrin e plotë të përgatitjes në fushën përkatëse. Pesha që zënë lëndët sipas kategorive, krahasuar me parashikimet ligjore në fuqi, është si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoria A, ka një ngarkesë prej 34 ECTS (18.89%) – standardi 15-20%. • Kategoria B, ka një ngarkesë prej 96 ECTS (53.34%) – standardi 50-55%. • Kategoria C, ka një ngarkesë prej 22 ECTS (12.22%) – standardi 12-15%. • Kategoria D, ka një ngarkesë prej 22 ECTS (12.22%) – standardi 10-15%. • Kategoria E, ka një ngarkesë prej 6 ECTS (3.33%) – standardi 3-5%.
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimit të studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	<p>Përmbajtja e programit të studimit bachelor në “Shkenca Politike”, mundëson vijimin e studimeve në programe të ciklit të dytë, sikurse dhe mundësinë e punësimit të të diplomuarve në këtë program studimi (<i>Evidencë 5_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 24_Plani mësimor i programit të studimit</i>). Lëndët e këtij programi studimi, i pajisin studentët jo vetëm me njohuri të përgjithshme, por edhe me njohuri të specializuara në disiplinën e shkencave politike, por edhe me aftësi për kërkimin shkencor, një element i rëndësishëm kryesisht për studentët që synojnë vijimin e programeve Master i Shkencave apo edhe të programeve të ciklit të tretë.</p>
Konkluzione	<i>GVJ, nisur nga gjetjet më lart shprehet se DSHP tregon një impenjim të mirë në drejtim të përmirësimit të vazhdueshëm dhe konsolidimit të programit bachelor në “Shkenca Politike”,</i>

	<i>përmes ndarjes mes formimit teorik dhe atij praktik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Gjatë vizitave të zhvilluara në institucion, dhe takimeve me aktorë të ndryshëm si staf akademik apo përgjegjes të departamentit, deklarohet se në funksion të përmirësimit të përmbajtjes së programit të studimit dhe përshtatjes me kërkesat e tregut të punës, strukturat përgjegjëse konsultohen me bashkëpunëtorë dhe partnerë nga tregu i punës. Ky rishikim bazuar në VKM nr 41. datë 24.01.2018 për "Elementët e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë, pati në fokus të këtij procesi riorganizimin e Programit të studimit Bachelor "Shkenca Politike" në masë mbi 20% ishte përmirësimi e kurrikulës dhe përshtatja me kërkesat e reja të vendosura nga MAS. (Evidencë 38_ Urdhër nr 67 datë 03.04.2018). <i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, por edhe gjatë vizitës së zhvilluar në institucion, nuk arrihet të evidentohen raste konkrete të ndryshimeve të kurrikulës të ardhura si rezultat i propozimeve nga partnerët nga tregu i punës.</i>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Studentët janë të përfshirë në vlerësimin periodik të procesit mësimor dhe jo vetëm, si nëpërmjet pyetësorëve, por edhe në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet kërkesave dhe ankesave që mund t'i drejtojnë Departamentit. (Evidencë 28_Pyetësori i studentëve, Evidencë 50). Analiza e pyetësorëve Gjatë takimit të zhvilluar me studentët e këtij programi studimi, doli në pah se studentët kishin hapësirat e nevojshme për të adresuar ankesat e ndryshme që mund të kishin lidhur me procesin mësimor, por edhe aspekte të tjera të jetës studentore. Gjithashtu në Rregulloren e UAMD Neni 121, pika 6 gërma b thuhet: "Të shprehin mendime dhe propozime për programet e studimeve të UAMD-së, rregulloret për veprimtaritë mësimore, si dhe të drejtën për të studiuar" (Evidencë 5_ Rregullore e UAMD)
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson,	Departamenti i Shkencave Politike si njësi përgjegjëse për programin e studimit bachelor në "Shkenca Politike" ka qënë në

përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	koherencë dhe në përmbushje të plotë të ndryshimeve të kuadrit ligjor duke i riorganizuar dhe përshtatur programet e tij të studimit. Përmirësimi dhe përmirësimi i programit të studimit, është një proces të cilin e evidentuam, gjatë diskutimeve në takimet e zhvilluara në institucion. Këto ndryshime lidheshin jo vetëm me përditësimin e syllabuseve por në tërësi me përmbajtjen e programit të studimit dhe emërtimin e tij.			
Konkluzione	<i>GVJ arrin në konkluzionin se departamenti si njësi përgjegjëse për programin e studimit bachelor në "Shkenca Politike" ka qenë në koherencë dhe në përmbushje të plotë të ndryshimeve të kuadrit ligjor duke i riorganizuar dhe përshtatur programet e tij të studimit. Angazhimi dhe përfshirja e studentëve si edhe dhe partnerëve apo organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit është i përmbushur.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët	Format e mësimdhënies, të tilla si leksionet, seminarët, orë të integruara të leksioneneve me seminarët, detyrat e kursit, projekte etj., janë të përcaktuara në planin mësimor (<i>Evidencë 24_Plani Mësimor i programit të studimit</i>), në syllabuset e lëndëve (<i>Evidencë 12_Syllabuset Programet mësimore të lëndëve</i>), sipas përcaktimeve në Rregulloren e Programit të Studimit (<i>Evidencë</i>

<p>laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p><i>5_Rregullore e Programit të Studimit).</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe diskutimeve me përfaqësues të ndryshëm, u konstatua se personeli akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma të ndryshme të mësimdhënies. Duke qenë se fusha e programit të studimit, Shkenca Politike, ka një natyrë kryesisht teorike, format klasike të mësimdhënies janë mbizotëruese, të cilat adoptohen edhe në bazë të nevojave të studentëve.</p> <p><i>(Evidencë 5_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 12_Syllabuset Programet mësimore të lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Bazuar edhe në aktet e brendshme rregullatore mbi aspektet didaktike <i>(Evidencë 4_Rregullore UAMD; Evidencë 5_Rregullore e Programit të Studimit)</i>, institucioni mbështet stafin akademik të përcaktojë në mënyrë autonome metodat pedagogjike, në funksion të përmbushjes së qëllimit dhe objektivave të programit të studimit në tërësi, por edhe lëndëve apo moduleve të veçanta, si pjesë përbërëse të kurrikulës. Institucioni e mbështet personelin akademik në përmirësimin e këtyre kompetencave, dhe nga marrëveshjet ndër-institucionale të bashkëpunimit të nënshkruara me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit. Në fokus të këtyre marrëveshjeve qëndrojnë: shkëmbimet e personelit akademik (pedagog, kërkues) për procesin mësimor dhe veprimtari kërkimore; nxitjen dhe realizimin e projekteve të përbashkëta kërkimore shkencore; organizimin e konferencave, trajnimeve, seminareve, etj. Këto elemente konstatohen si nga takimet e zhvilluara në institucion, ashtu edhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë në kuadër të akreditimit të këtij programi studimit.</p> <p><i>(Evidencë 2_Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD 2020-2025; Evidencë 25_RV për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 20-21; Evidencë 44_FSHPJ- Lista e marrëveshjeve bilaterale për shkëmbime).</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të</p>	<p>Nga analiza e dokumentacionit të përcjellë nga institucioni, konstatuar edhe gjatë takimeve të zhvilluara me stafin akademik dhe drejtuesit e njësisë bazë dhe kryesore, por edhe me studentët e këtij programi studimi, arrihet në konkluzionin se personeli akademik është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, sipas tematikave dhe</p>

<p>ndryshme të mësimdhënies 23nnovative23 dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>profilit të lëndëve ku ata janë të angazhuar. (<i>Evidencë 13_CV e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit SHP; Evidencë 16_Personeli akademik i angazhuar në SHP</i>).</p> <p>Përdorimi i metodave inovative, sikurse dhe kombinimi i metodave klasike me ato interaktive, garantojnë që format dhe metodat e mësimdhënies të inkurajojnë sensin e autonomisë te studentët. Kombinimi i metodave klasike me ato interaktive, u konstatua si nga takimet e zhvilluara me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe me studentët. Organizimi i detyrave në grup apo individuale, prezantimet, etj., ndikojnë në përmbushjen e këtij kriteri, i cili u konstatua edhe gjatë takimeve të zhvilluara me studentët e këtij programi studimi.</p> <p>(<i>Evidencë 24_Plani Mësimor i programit të studimit; Evidencë 12_Syllabuset e lëndëve SHP; Evidencë 5_Rregullore e Programit të Studimit</i>).</p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë 23nnovat dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Rishikimi i programeve të lëndëve si në aspektin përmbajtësor ashtu edhe metodat e mësimdhënies, duke marrë në konsideratë edhe kërkesat e studentëve dëshmon për përmbushjen e këtij kriteri nga ana e personelit akademik të përfshirë në programin e studimit në proces akreditimi. (<i>Evidencë 25_RV për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 20-21; Evidencë 28_Pyetsor studenti; Evidencë 50_Analiza e pyetësorëve të studentëve, staf akademik, staf administrativ</i>)</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe</p>	<p>Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, bashkëpunon me njësi të tjera në nivel njësie kryesore por dhe në nivel institucional, të tilla si Komisioni i Përhershëm të garantimit të standarteve dhe cilësisë për sigurimin e standardeve të cilësisë në nivel institucional, Njësia e sigurimit të cilësisë në nivel Universiteti, Njësia e sigurimit të cilësisë e njësisë kryesore dhe Drejtorja e Kurrikulës dhe standarteve të Cilësisë, etj. Institucioni harton një raport periodik vetëvlerësimi për të monitoruar mënyrën e organizmit dhe menaxhimit përmirësimin dhe përshtatjen e kurrikulave me nevojat e tregut të punës, mësimdhënien dhe mësimnxënien, Kërkimin shkencor, studentët dhe mbështetja për ta.</p> <p>(<i>Evidencë 6_Rregullore për funksionimit dhe organizimin e sistemit të brendshëm të cilësisë; Evidencë 25_RV për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 20-21</i>).</p>

zbatimit të metodave të reja.				
Konkluzione	<i>GVJ arrin në konkluzionin se metodat e mësimdhënies janë një ndërthurje e metodës klasike të shpjegimit me projektme të materialeve mësimore të përgatitura nga pedagogët e lëndëve. Personeli akademik dhe procesi mësimor janë në vlerësim periodik nga ana e studentëve përmes pyetësorëve dhe nga Nj.S.B.C. Studentët shprehin mendimet dhe kërkesat e tyre edhe përmes përfaqësuesve në Këshillin Studentor. Kryetari i Këshillit Studentor është pjesë e Senatit Akademik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Kriteret dhe mënyra e vlerësimit të njohurive janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore (<i>Evidencë 4_Rregullore e UAMD; Evidencë 5_Rregullore e Programit të Studimit</i>), sikurse dhe në syllabusin e secilës lëndë (<i>Evidencë 12_Syllabuset e lëndëve SHP</i>), të cilat i vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo semestri. Vlerësimi në një lëndë mund të bëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • me provim me shkrim; • me detyra kursi, projekte • i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi. <p>Në syllabuset e lëndëve janë të përcaktuara format e vlerësimit të vazhdueshëm dhe pesha specifike në përqindje e secilit prej komponentëve të vlerësimit.</p> <p>(<i>Evidencë 12_Syllabuset e lëndëve SHP</i>).</p>
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga	<p>Në syllabuset e lëndëve (<i>Evidencë 12_Syllabuset e lëndëve SHP</i>), të cilat i vihen në dispozicion studentëve në fillim të çdo semestri, janë të përcaktuara format e kontrollit të dijeve, të cilat janë në përputhje me aktet e brendshme rregullatore (<i>Evidencë 5_Rregullore e Programit të Studimit</i>). Vlerësimi i një lënde bëhet me provim me shkrim, me detyra kursi/projekte, ose i bazuar në një shumëllojshmëri formash vlerësimi. Gjatë takimit të zhvilluar me studentët, u konstatua se ata dispononin informacionin e plotë lidhur me format dhe kriteret e vlerësimit për secilën lëndë.</p>

titullari i lëndës/modulit.	
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Format e kontrollit të dijeve janë të ndryshme dhe përfshijnë: pjesëmarrjen aktive në seminare, dorëzimi i detyrave/projekteve, provim i ndërmjetëm dhe provimi përfundimtar. Komponentët kryesorë të vlerësimit, janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Provimi i ndërmjetëm (40%) • Provimi përfundimtar (50%) • Projektet / detyrat e kursit (10%) <p>Vlerësimi bazuar në pikët e përfutuara është:</p> <p>nota 4: 0 – 504 pikë; nota 5: 505-574 pikë; nota 6: 575-664 pikë; nota 7: 665-754 pikë; nota 8: 755-844 pikë; nota 9: 845-934 pikë; nota 10: 935-1000 pikë</p> <p><i>(Evidencë 12_Syllabuset Programet mësimore të lëndëve).</i></p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>UAMD, ka zgjedhur si indikator shumë të rëndësishëm për të siguruar përfshirjen e studentëve në vlerësimin e procesit mësimor dhe vlerësimit të tyre, pyetësorët standard të cilat ju vihen në dispozicion studentëve dy herë në vit në cdo fund semestri. FSHPJ, DSHP, analizon këto pyetësorë duke evidentuar ecurinë në mësimdhënie, duke përfshirë vazhdimisht studentët në këtë proces, dhe marrin masat e nevojshme për përmirësimin e mëtejshëm të metodologjisë së mësimdhënies. Mendimet e sygjerimet e studenteve të dalin gjatë përpunimit të pyetësorëve kanë shërbyer si pika referimi të vlerësimit të punës nga stafi angazhuar në mësimdhënie duke respektuar konfidencialitetin e të dhënave.</p> <p><i>(Evidencë 28- Pytësori i studentëve)</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies</p>	<p>Përdorimi i metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies, përbën një objektiv të rëndësishëm të institucionit, e përcaktuar në dokumente kryesore strategjike <i>(Evidencë 2_Plani i Zhvillimit Strategjik të UAMD; Evidencë 25_Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë; 4.19_Politika për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies)</i>. Në funksion të përmbushjes së këtij objektiivi, institucioni zhvillon një sërë veprimtarish <i>(Evidencë 14_Rregullore e Drejtorisë së administrimit dhe shërbimeve Akademike, Evidencë 25. Raporti i vetëvlerësimit UAMD)</i>. Në këtë dokument Politika për zhvillimin akademik dhe profesional të</p>

inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësuesit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	personelit akademik evidentohet nëpërmjet veprimtarive të ndryshme si: <ul style="list-style-type: none"> • Kurse të shkurtra (sipas nevojave të identifikuara dhe në mbështetje të zbatimit të risive pedagogjike). • Konferenca, seminare, shkolla verore dhe ditët e informimit. etj.			
Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se Institucioni ka të përcaktuara qartë dhe garanton të gjitha procedurat që nevojiten për vlerësim të njohurive, dijeve personale dhe aftë sive profesionale të çdo studenti.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	<p>Procesi i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik (semestrave), i cili konstatohet nga vlerësimi për dy provime (i ndërmjetëm dhe përfundimtar), pjesëmarrjes aktive në seminar, detyrat e kursit dhe projektet (<i>Evidencë 4, Neni 68- kontrolli i dijeve Evidencë 5_Rregullore e Programit të Studimit; Evidencë 12_Syllabuset-Programet mësimore të lëndëve</i>).</p> <p>Komponentët kryesorë të vlerësimit, të cilat kanë kombinime të ndryshme në lëndë janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Projekt/ Detyrë Kursi: 10 % • Provim i ndërmjetëm: 40 %. • Provim përfundimtar: 50 %
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	<p>Institucioni ka një marrëveshje bashkëpunimi pjesë e projektit Clean Score e mbështetur kjo nga Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim. (<i>Evidencë referuar RVB, Nr 52 https://cleanscore.al/arkiva/794</i>)</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, por edhe gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se përdorimi sistemeve elektronike të testimit dhe vlerësimit në lëndët e këtij programi studimi, të cilat</p>

	do të ndikojnë në reduktimin e formave të abuzimit dhe rritjes së transparencës, ky sistem përdoret vetëm në rastet kur teza ishte e hartuar vetëm me pyetje alternative.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Në syllabuset-programet e lëndëve janë të pasqyruara mënyrat e vlerësimit, kjo në përputhje dhe aktet ligjore dhe nënligjore. <i>(Evidencë 12-Syllabuset e lëndëve bachelor SHP)</i>
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënësve për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Gjatë vizitave në institucion, u konstatua se pas zhvillimit të provimeve dhe publikimit të rezultateve, pedagogët diskutojnë me studentët mbi zgjidhjen e tij, duke ndikuar në përmirësimin e dijeve në vijim. Kjo e drejtë është e përcaktuar edhe në aktet e brendshme rregullatore. <i>(Evidencë 4_Rregullore e UAMD Neni 69 , Evidencë 5 _Rregullore e programit të studimit -Neni 28- Zhvillimi i provimeve).</i>
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në aktet e brendshme rregullatore, janë të përcaktuara rregullat për zhvillimin e procesit të provimeve <i>(Evidencë 4_ Rregullore e UAMD, Neni 70, Evidencë 5_Rregullore e programit të studimit-Neni 29-Rregullat e provimit)</i> . Procesi i sekretimit, sikurse dhe monitorimi i sallës gjatë zhvillimit të provimeve, janë mekanizma të cilat ndikojnë në përmbushjen e këtij kriteri.
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet u bëhen të njohura studentëve në sistem nga pedagogu, në përfundim të provimit, brenda 72 ditëve nga data e zhvillimit të provimit. Rezultatet komunikohen individualisht. Pas këtij ballafaqimi, pedagogu duhet të dorëzojë pranë sekretarisë mësimore të fakultetit, procesverbalin me vlerësimin përfundimtar. <i>(Evidencë 4_Rregullore UAMD, Evidencë 5_Rregullore e programit të studimit).</i>
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit, sikurse dhe të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa paraqitet me shkrim tek Dekani jo më vonë se tre ditë nga marrja e vlerësimit. Dekani mund t'ja kalojë për shqyrtim përgjegjësit të njësisë bazë, departamentit, i cili vë në dijeni personelin akademik e më pas dorëzon një relacion tek drejtuesi i njësisë kryesore, Dekani vlerëson ose jo të drejtë pretendimin e studentit. <i>(Evidencë 4_Rregullore e UAMD, Neni 71).</i>
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga	Sikurse është analizuar edhe në kriterin e mësipërm, institucioni ka të mirë përcaktuar procedurën për pranimin dhe shqyrtimin e

<p>komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>ankesave. Kjo e drejtë e studentëve u konfirmua edhe gjatë vizitës në institucion dhe takimit me studentët e këtij programi studimi. Drejtuesi i njësisë kryesore nëse verifikon shkelje të korigjueshme, në bashkëpunim me Komisionin e Provimit, bëjnë korigjimet e duhura, në të kundërt, ngre komisionin <i>ad-hoc</i>. Komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit i propozon Dekanit, i cili pasi njihet me të gjithë procedurën dhe nëse gjen të drejtë ankesën e studentit, anulon provimin dhe merr vendim për rihvillimin e provimit. Me miratimin e Dekanit, Komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.</p> <p><i>(Evidencë 4_Rregullore e UAMD, Neni 71).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konkludoi se UAMD harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura të drejta e transparente të aksesueshme nga palët e interesuara lidhur me përparimin e studentëve, dhe vlerësimin e dijeve në programin e studimit, duke respektuar sistemin e meritës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit, e kombinuar me mënyrën e zhvillimit të saj, garanton thellimin e njohurive dhe aftësive profesionale <i>(Evidencë 24_Plani Mësimor i programit të studimit; Evidencë 12_Syllabuset e lëndëve bachelor SHP)</i>. Viti i parë akademik nis me lëndë të përgjithshme, për të shkuar gradualisht në semestrat dhe vitet në vijim, drejtë lëndëve karakterizuese të programit, dhe deri tek praktika profesionale dhe diplomimi.</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Programi i studimit Bachelor në “Shkenca Politike”, ka lëndë të dedikuara zhvillimit të aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit si lëndën e Informatikës, Komunikim Politik dhe Gjuhë të Huaj.</p> <p><i>(Evidencë 24_Plani Mësimor i programit të studimit).</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe</p>	<p>Rishikimi i kompetencave dhe aftësive të fituara nga studenti në</p>

<p>aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>secilën lëndë, është pjesë integrale e rishikimit të syllabuseve dhe përmirësimit të programit të studimit në tërësi. Gjatë takimeve të zhvilluara si me personelin akademik ashtu edhe me studentët, u konstatua se në përfundim të lëndëve/moduleve, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme të trajtuara në atë lëndë/modul dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Në tërësi, mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në lëndë të ndryshme të programit të studimit. Për vetë natyrën e programit të studimit, fushës së tij, nuk gjenden shumë elementë të lidhur me mundësi për të zhvilluar njohuri të marra në laboratorë, por duhet përmendur fakti se detyrat e kursit apo projektet përfundimtare shpesh herë pasqyrojnë kompetencat e studentëve gjatë zhvillimit të lëndëve të ndryshme. Nëse këto projekte ofrojnë ide inovative apo janë të një niveli ku pasqyrohet cilësi kërkimore, atëherë këta studentë inkurajohen nga pedagogët e tyre duke i përfshirë në aktivitete të ndryshme si konferenca, workshope, etj.</p> <p><i>(Evidencë 40_Buletini i aktiviteteve FSHPJ).</i></p> <p>Gjatë takimeve me personelin akademik dhe studentët, u konstatua se personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup. Në këtë mënyrë, studentët pajisen me aftësi dhe kompetenca për identifikimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme në fushën e shkencave politike. Bashkëpunimi me institucione të ndryshme ka rritur mundësinë për stafin akademik për të ndërthurur si format e mësimdhënies ashtu edhe për të rritur mobilitetin si të vetë stafit akademik, por kjo jo e reflektuar për studentët e këtij program studimi. Personeli akademik është vazhdimisht i angazhuar si pjesë e mobiliteteve ndërkombëtare për arsye trajnimesh profesionale, bashkëpunimesh kërkimore si dhe angazhim në mësimdhënie. <i>(Evidencë 31_Formular vetëvlerësimi të performancës së personelit akademik).</i> Falë këtyre eksperiencave personeli akademik ofron një mësimdhënie të përafërt me format e mësimdhënies me institucionet partnere me të cilat FSHPJ ka marrëveshje bashkëpunimi për të zhvilluar mobilitete studentore. <i>(Evidencë 39_FSHPJ - Lista e mobiliteteve të stafit akademik; Evidencë 45_Raport vjetor për veprimtarinë mësimore, kërkimore shkencore dhe financiare).</i></p>
<p>Kriteri 5. Personeli</p>	<p>Gjatë takimeve në instiucion me personel akademik dhe studentë</p>

akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>të këtij programi studimi na u referua se në institucion zhvillohen leksione të hapura dhe aktivitete të tjera ekstrakurrikulare, të cilat lidhen si me zhvillimet e fundit në fushën e programit të studimit, ashtu edhe në fusha të tjera interdisiplinare apo me karakter praktik dhe aplikativ.</p> <p><i>Këto dokumenta ishin të viteve të kaluara dhe GVJ nuk gjeti një listë të këtyre aktiviteteve të zhvilluar të paktën në dy vitet e fundit.</i></p> <p><i>(Evidencë 26_Analiza e DSHJ; Evidencë 42, 45_Raport vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore e financiare).</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ mbështetur në dokumentacion dhe vizitën në IAL konstatoi se institucioni nëpërmjet strukturave të posaçme, realizon mbi bazë kompetencash një mësimdhënie e cila është dinamike duke siguruar tek studentët përmirësim të mësimnxënies në vazhdim.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Në aktet e brendshme rregullatore, është përcaktuar procedura e posaçme për diplomimin, si për rastet e punimit të temës së diplomës, ashtu edhe provimit të diplomimit me peshë 6 ECTS. <i>(Evidencë 4_Rregullore e UAMD, Neni 75 (Mbrojtja e Diplomës), Neni 76 (Organizimi dhe zhvillimi i diplomimit); Evidencë 5_Rregullore e Programit të Studimit).</i> Këto dokumente dhe informacioni mbi këtë proces, u vihet në dispozicion studentëve, gjë e cila u shpreh edhe gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, kryesisht ata që diplomoheshin në v.a. 22-23.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Studentët asistohen si në aspektin e informimit të tyre lidhur me procesin e provimit final apo mbrojtjes së diplomës, ashtu edhe të përgatitjes për zhvillimin e provimit apo mbikëqyrjen e punimit të diplomës <i>(Evidencë 5_Rregullore e programit të studimit, Neni 37; 38, 40).</i> Studentëve ju vihej në dispozicion një bankë pyetjesh orientuese lidhur me përgatitjen për provimin final (diplomi) si dhe nga departamenti organizohej një sesion i veçantë informues për këtë provim. Të drejtën për ta finalizuar me temë diplome e kanë ata studentë që kanë mesataren e miratuar nga njësia

	kryesore për atë vit akademik. Ky asistim u konstatua edhe gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Duke qenë se ky është program i ciklit të parë dhe detyrimin përmbyllës e ka me provim formimi, përveç në rastet kur studentët kanë mesataren e miratuar nga dekani i FSHPJ, bazuar në aktet e brendshme rregullatore, komisioni ad-hoc i ngritur nga drejtuesi i njësisë bazë, për hartimin e programit të provimit të diplomës bazohet në lëndët e kategorive A, B dhe C (nga kjo kategori përjashtohen lëndët me zgjedhje), të cilat përcaktohen me vendim të DSHP. Pyetjet hartohen nga titullarët e lëndëve. <i>(Evidencë 5_Rregullore e programit të studimit)</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	Studentët që do të diplomohen, si me provim final ashtu edhe me temë diplome, marrin orientimet e nevojshme nga personeli akademik efektiv por edhe ai me kontratë. Kriteret dhe procedurat e diplomimit janë të përcaktuara në aktet e brendshme rregullatore. Programi i provimit final i vihet në dispozicion studentëve në fund të semstrit të parë të viti të tretë, ndërsa për studentët që do të përgatisin temë diplome, Departamenti publikon temat e mundshme të diplomave, sikurse përcakton edhe pedagogun udhëheqës, i cili asiston studentin në përgatitjen e punimit të diplomës, sipas standardeve të institucionit. <i>(Evidencë 5_Rregullore e programit të studimit).</i> Udhëheqësi i diplomës garanton se punimi është realizuar sipas standardeve shkencore dhe përmbush kriteret institucionale për kërkimin shkencor. <i>(Evidencë 4_Rregullore e UAMD).</i> Përgatitja e punimit kryhet sipas një plani të dakordësuar ndërmjet udhëheqësit shkencor dhe studentit. Udhëheqësi miraton punimin përpara se studenti të paraqitet në komisionin për mbrojtjen e diplomës.
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Udhëheqësi i diplomës asiston studentët që ka në udhëheqje në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Parimet kryesore të Shkrimit Akademik dhe të Kërkimit, studentët i marrin që në momentin e zhvillimit të këtyre lëndëve të cilat zhvillohen që në vitin e parë semestri dytë. <i>(Evidencë 24_Plani mësimor SHP).</i> Për shkak të ciklit të studimeve dhe natyrës së programit të studimit, pritshmëria për kërkim shkencor të mirëfilltë (mbledhja e të dhënave parësore në terren) është relativisht e ulët.
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës,	Vlerësimi kryhet me pikë sipas skedës së vlerësimit që përfshihet në paketën e punimit të diplomës, pikë të cilat konvertohen në notë. Nota regjistrohet në procesverbal, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. Vlerësimi i komunikohet studentit

studenti vlerësohet me notë.	individualisht. <i>(Evidencë 4_Rregullore e UAMD, Neni 68 dhe Aneks diplomimi)</i>			
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studentit pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve në programin Bachelor në “Shkenca Politike”, studentët pajisen me diplomën, listën e notave dhe suplementin e diplomës të miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin <i>(Evidencë 4_Rregullore e UAMD; Evidencë 9_Shkresa e QSHA për miratimin e formatit të diplomës; Shkresa e QSHA për regjistrimin e diplomës; Modeli i suplementit të diplomës)</i> . Në përfundim të studimeve, studentit merr një kopje zyrtare të plotë të programit të studimit të zhvilluar, sikurse dhe plan programet e plota sipas kërkesës së tij.			
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Sekretaria Mësimore, menaxhon dhe administron të gjithë informacionin e studentëve ndër vite. Të gjitha të dhënat e studentëve, që nga fillimi i studimeve deri në diplomimin e tyre gjenden në databazën e Sekretarisë Mësimore, si dhe në regjistrin themeltar të notave. Sekretaria Mësimore arkivon dhe mban në dosje dokumentet e çdo studenti që është i regjistruar, është çregjistruar, si dhe të studentëve që kanë mbaruar studimet e tyre <i>(Evidencë 4_Rregullore e UAMD, Neni 83; Evidencë 8_Manual për funksionimin e sekretarisë mësimore)</i> .			
Konkluzione	<i>GVJ konkludoi se strukturat përgjegjëse, personeli akademik dhe ndihmës akademik ndjekin procedura te qarta lidhur me detyrimet akademike të çdo studenti dhe e pajis atë me dokumentacionin e nevojshëm.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret **Vlerësimi i ekspertëve**

Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.

GVJ vlerëson se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjeshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike”, në Departamentin e Shkencave Politike, Fakulteti i Shkencave Politike-Juridike, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik dhe përmbushin kërkesat ligjore në fuqi pasi kanë një nivel kualifikimi më të lartë sesa cikli i studimeve ku angazhohen në mësimdhënie. 2-3 pedagogë vijnë nga përvoja edhe si drejtues si zv. Rektore të UAMD, zv. Dekane dhe ish Drejtuesia e Departamentit.

Ky vlerësim bazohet në shqyrtimin e dosjeve të personelit në zyrën e Burimeve Njerëzore dhe në takimin e drejtpërdrejtë me stafin akademik dhe atë ndihmës në UAMD, ku titullarët e lëndëve janë të me gradën shkencore Dr. ose të kategorisë profesor. Fusha akademike e lektorëve të angazhuar në programin master shkencor në Shkenca Politike është në përputhje me modulet dhe lëndët ku ata janë aktivizuar. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie ka një eksperiencë disavjeçare edhe në fushën kërkimore. Kjo vërtetohet edhe nga shqyrtimi që GVJ u bëri CV akademike të tyre, me angazhime si botime, grupe kërkimore e shkencore sipas fushave specifike që mbulojnë.

Tituj/grada	2020-2021		2021-2022		2022 – 2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	-		1	-	1	-
Prof.As.Dr	3	-	3	-	4	-
Dr/PhD	15	3	13	2	12	4
Msc	1			-	-	-
Në total	19	3	17	2	17	4

(Evidencë 16. Personeli Akademik në SHP).

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me *Udhëzimin Nr.29 datë 10.9.2018* të MAS, si edhe në Rregulloren e UAMD neni 107), duke respektuar kriterin e numrit të lëndëve (tre) dhe normës mësimore. Lëndët e programit Bachelor mbulohen me 90% nga personeli akademik i UAMD, jo vetëm të Departamentit të

	<p>Shkencave Politike, por edhe të departamenteve të tjera në UAMD. Niveli i kualifikimit dhe fushat akademike-kërkimore të tyre i përgjigjen natyrës dhe specifikave të lëndëve e moduleve që ata zhvillojnë. Personeli akademik efektiv mbulon ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, normat janë të tejkaluara që variojnë nga 130 - 330 orë mbi normat mësimore, por kjo lidhet me mësimdhënien në disa departamente, jo vetëm në Departamentin e Shkencave Politike. Edhe në rastet kur stafi akademik efektiv mbulon më tepër sesa tre lëndë, si B.GJ. me 5 lëndë, ato janë paka a shume të lidhura me median dhe komunikimin, Brenda së njëjtës fushë; e njëjta për prof. L.A., etj.</p> <p><i>(Evidenca Nr 4 Rregullore e UAMD;</i></p> <p><i>Evidencë 16. Personeli Akademik në SHP;</i></p> <p><i>Evidenca 17. Ngarkesa mësimore e personelit akademik DSHP</i></p> <p><i>Evidencë 13. CV e stafit akademik të Programit).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>GVJ në takimin me burimet njerëzore dhe bisedën me stafin akademik efektiv dhe jo efektiv në UAMD konstatoi se personeli akademik i angazhuar në realizimin e këtij programi studimi kanë një angazhim disavjeçar në kurset përkatëse, dhe drejtuesi i Departamentit ka gati 10 vjet si personel akademik efektiv në UAMD, duke kaluar shkallët e karrierës nga asistent lektor, arrin gradën shkencore Doktor e së fundmi fiton titullin profesor i asociuar. Po në karrierë në ngjitje kanë qenë edhe pjesa tjetër e stafit akademik, ish drejtuesja e Departamentit që tregon qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit. Kontratat e punësimit të shqyrtuara ishin sipas kërkesave të Kodit të Punës duke mbuluar me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të gjithë të punësuarit.</p> <p><i>(Evidenca Nr.13 CV e Stafit Akademik të programit; Evidencë 43. Model Kontrate Staf Akademik me kohë të plotë).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe</p>	<p>Nga takimi i GVJ me njësinë e Burimeve Njerëzore në UAMD, na u vu në dispozicion CV akademike dhe kontratat e punës, si dhe procedurat standarde të rekrutimi dhe vlerësimit. Ato provuan se UAMD mbështetet në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit, procedurë transparente të rekrutimit të stafit akademik efektiv dhe jo efektiv në përputhje me aktet ligjore dhe Rregulloren e UAMD dhe Rregulloren specifike të NJBNJ. Një sugjerim nga bisedat me stafet akademike në UAMD ishte që afati prej 10 ditësh për rekrutimin e stafit joefektiv të rritet.</p>

<p>përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p><i>(Evidenca Nr.13 CV e Staffit akademik; Evidenca Nr.4 Rregullore e UAMD; Evidenca Nr.1 Statuti i UAMD; Evidenca 7. Rregullore Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Mbështetur në natyrën specifike të këtij programi studimi, personeli ndihmës mësimor shkencor angazhohet në kryerjen detyrimeve plotësuese si: praktikë mësimore apo/dhe informatikë ku kërkohen ambiente të tilla si laborator IT. Fakulteti i Shkencave Politike Juridike ka në dispozicion auditorë bashkëkohorë të nevojshëm për plotësimin e kërkesave të lëndëve, apo moduleve të këtij programi studimi, i cili nuk ka nevojë për ndonjë teknologji të avancuar. Dy laboratorët në krah të Bibliotekës që vizitoi GVJ, përdorshin si për mësim, edhe për përdorimin e platformave online të bibliotekës.</p> <p><i>(Evidenca 7. Rregullore Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike).</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Statistikat mblidhen dhe përpunohen periodikisht çdo vit akademik nga Drejtoria e Administrimit dhe Shërbimeve Akademike dhe raportohen në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit në formë elektronike dhe në hardcopy. Këto të dhëna përfshijnë statistikën mbi personelin akademik efektiv dhe jo-efektiv, ndihmës-akademik me kohë të plotë e të pjesshme, personelin akademik sipas titujve dhe gradave, statistika mbi ngarkesën mësimore të personelit akademik, etj.</p> <p><i>(Evidencë 7. Rregullore Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Juridike; Evidencë 14. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike).</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën</p>	<p>Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës nënshkruan në mënyrë të vazhdueshme marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike, bashkinë, biznese dhe organizata të shoqërisë civile për praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike të studentëve. Aktualisht UAMD ka marrëveshje bashkëpunimi për zhvillimin e praktikave profesionale me 31 institucione publike, organizata dhe biznese për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve. Gjithashtu bazuar në projektet e stafit akademik, ato u shprehen gjatë takimit me GVJ se bashkëpunimi me njësitë e qeverisjes vendore dhe OSHC ka qenë i frutshëm. Laboratorët</p>

<p>profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>kompjuterikë që përdoren nga personeli akademik dhe studentët për zhvillimin e praktikave të tyre mësimore për lëndët që kërkojnë pajisje të tilla janë mundësuar nga bizneset partnere të UAMD.</p> <p><i>(Evidencë 37. Marrëveshjet e bashkëpunimit UAMD; Evidencë 44. FSHPJ-Lista e marrëveshjeve bilaterale për shkëmbime; Evidenca Nr.44.1 Marrëveshjet e Bashkëpunimit të Departamentit të Shkencave Politike në UAMD).</i></p>			
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, ndihmon studentët në përmbushjen e detyrimeve dhe harton një raport përfundimtar të praktikës duke dhënë dhe vlerësimin për studentin që ka kryer praktikën. Praktikën studentët e zhvillojnë edhe duke punuar me pedagogët për projektet e tyre kërkimore. Konkretisht gjatë takimit me stafin akademik në UAMD, profesoresha E.P solli shembullin e vet në angazhimin e disa studentëve në një projekt kerkimor që ajo drejtonte që lidhej me fushatën zgjedhore.</p> <p><i>(Evidenca Nr.44 FSHPJ-Lista e marrëveshjeve bilaterale për shkëmbime; Evidencë 5. Rregullore programit SHP).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht pasi personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit ka kualifikimin e duhur akademik në përputhje me fushën e programit Bachelor në "Shkenca Politike". Ai është rekrutuar sipas kriterëve dhe procedurave transparente për garantimin e një përzgjedhje sipas meritës; stafi është i qëndrueshëm, siguron mësimdhënie bashkëkohore dhe është i përfshirë në kërkim shkencor sipas fushave të programit të studimit.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të

GVJ vizitoi mjediset e UAMD në kampusin e ri dhe vlerëson se Departamenti i Shkencave Politike ka mjediset e brendshme të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike

<p>përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>brenda auditorëve. Përmirësimi i infrastrukturës së auditorëve dhe mjediseve të punës janë të mjaftueshme për numrin e studentëve në përputhje dhe modulet e zhvilluara. Problematikë e ngritur nga studentët, por që është e pranishme edhe për stafet akademike dhe administrative të UAMD mbetet transporti publik i studentëve dhe stafit për shkak të mungesës së një sistemi transporti publik në çdo kohë të asaj zone. Pavarësisht kushteve të kënaqshme që ofron godina e UAMD, dhe sipërfaqeve të lira në mjedisin përreth, në UAMD mungojnë mjediset sportive dhe argëtuese për studentët.</p> <p><i>(Evidencë 29. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit).</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ pasi vizitoi mjediset e UAMD konfirmon se ka auditorë bashkëkohore për realizimin e procesit mësimor teorik e praktik të programit të studimit. Në Kampusin Universitar të UAMD krahas auditorëve ka edhe 2 laboratorë për të realizuar procesin mësimor si dhe praktikat mësimore që ndodhen në krah të Bibliotekës. Aty mund të përdoren platformat e bibliotekës online.</p> <p><i>(Evidencë 29. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit).</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p><i>Natyra e programit nuk kërkon laboratorë apo atelie specifike.</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Fakulteti i Shkencave Politike Juridike disponon auditorë sipas natyrës së programit të studimit dhe 2 laboratorë me kompjutera, të mjaftueshëm për numrin e studentëve të Bachelorit në “Shkenca Politike”.</p>

Konkluzione	<i>GVJ konfirmon se UAMD disponon një kampus universitar me mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit. UAMD dhe Departamenti i Shkencave Politike për formimin praktik të studentëve sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit kanë nënshkruar një sërë marrëveshjes me institucione publike, biznese dhe OSHC. Problematikë mbetet transporti publik i studentëve dhe stafit për shkak të mungesës së një sistemi transporti publik në çdo kohë të asaj zone.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ pas shqyrtimit të syllabuseve dhe diskutimit me stafin akademik, bibliotekaren dhe studentët, <i>vlerëson se biblioteka ka nevojë për literatura fizike bashkëkohore, të cilat kanë munguar nga viti 2016 në atë bibliotekë.</i> Në bibliotekë gjendeshin disa dispenca në trajtën e leksioneve të printuara nga titullarët e lëndëve, sipas kriterëve bazuar në Rregullore e Këshillit të Botimit, në gjuhën e programit të studimit (shqip). Kjo literaturë është e përshtatshme për të dhënë njohuritë e kërkuara për këtë program studimi. Leksionet e përkthyer nga pedagogët zëvendësojnë literaturën e detyrueshme apo dhe atë plotësuese, por në disa raste ato nuk disponohen në Bibliotekë që të jenë njëlloj të aksesueshme për të gjithë studentët. <i>(Evidencë 12. Syllabuset e lëndëve BSC SHP).</i>
.Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	DSHP propozon çdo vit literatura sipas syllabuseve të programit të studimit, ndonëse vitet e fundit sidomos pas COVID 19 janë fokusuar më tepër në literaturat online dhe jo pasurimit të bibliotekës me libra fizike. Në Rregulloren e Bibliotekës së UAMD përcaktohet politika e pasurimit të saj për mbështetjen e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor nëpërmjet, blerjeve, dhuratave, projekteve dhe shkëmbimit midis bibliotekave. <i>(Evidencë 11. Rregullorja e bibliotekës shkencore të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës).</i>

<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ vizitoi Bibliotekën rreth 35 m² në godinën Nr 2 të kampusit universitar, e cila i shërben FSHPJ, por që të gjitha mjediset bibliotekare mund të përdoren nga studentët në mënyrë të barabartë. Mundësia e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët është krijuar përmes katalogut online të Bibliotekës. Ndonëse salla e librit është e vogël, ajo ka përreth dy laboratorë me kompjutera, ku studentët studiojnë duke ju ofruar një literaturë të pasur online në fushën e shkencave politike.</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Biblioteka e kampusit universitar UAMD ofron literaturë mësimi për programin e studimit në Bachelor në “Shkenca Politike”. Krahas librit fizik (mbi 12.000 njësi bibliotekare) ajo ofron edhe librin elektronik, i ruajtur në CD, server, hard disk i jashtëm (mbi 10000 tituj). Biblioteka është e pajisur me pajisje teknologjike që mundësojnë kërkimin e shpejtë të literaturës fizike e digjitale. Studentët kanë akses në EBSCO, i cili ofron mbi 170 mijë libra elektronike nga Universitetet më prestigjioze të botës, mbi 6 mijë periodike dhe revista të Web of Science apo Scopus. Fondi i bibliotekës përfshin burime në gjuhën shqipe dhe të huaj, por që nga viti 2016 nuk është pasuruar me tituj e formate të rinj, por që plotësohet nga biblioteka online. Fondi i bibliotekës është i mjaftueshëm dhe i përshtatshëm për mbulimin e të gjitha disiplinave mësimore që ka ky program studimi.</p> <p><i>(Evidencë 20. Informacion për Bibliotekën Online).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Institucioni krijon kushte për literaturën bazë dhe ndihmëse duke ofruar edhe shërbim në version on-line. Ky shërbim ofrohet në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët, pa pagesë, përmes sistemit me “kod të hapur” dhe ka instaluar falas <i>Katalogun Online të Integruar</i> për menaxhimin e fondit të saj. Sistemi i ri i quajtur “Koha”, “pa kosto” siguron informacion edhe jashtë ambienteve të universitetit. <i>(Evidencë 20. Informacion për Bibliotekën Online).</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Biblioteka e ndodhur në katin e katërt që GVJ vizitoi kishte 20 vende qendrimi pa kompjutera, që ishin të mjaftueshme për numrin e vogël të studentëve të këtij programi studimi. Ajo ka përreth dy laboratore me kompjutera, ku studentët studiojnë duke iu ofruar një literaturë të pasur online pa pagesë. Interneti është i aksesueshëm në të gjitha mjediset e UAMD. Nga biseda me studentët, rezultoi që ata e preferonin literaturën online në formatin elektronik, sipas orientimit të pedagogëve.</p> <p><i>(Evidencë 29. Të dhëna për infrastrukturën në funksion të programit të studimit; Evidencë 11. Rregullorja e bibliotekës shkencore të universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, 2019;</i></p>

	https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/).
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	<p>Sikurse u konfirmua nga biseda e GVJ me bibliotekaren dhe studentët e këtij program studimi, Biblioteka ishte në dispozicion të studentëve në oraret e funksionimit të UAMD, sipas nevojave të studentëve, madje edhe përtej tyre në fundjavë.</p> <p><i>(Evidencë nr. 32. Kalendari i funksionimit të Bibliotekës në fundjavë).</i></p>
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin e fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	<p>Nga biseda e GVJ me stafin e Departamentit të Shkencave Politike, ka një planifikim vjetor për blerjen e literaturave bashkëkohore për realizimin e programit të studimit për shtimin dhe përditësimin e zërave të bibliotekës. Pas takimit me bibliotekaren konstatuam se vitet e fundit nuk ka pasur shtim të librave fizikë, pas vitit 2016, pasi vëmendja ka qenë në bibliotekën online. Me shfrytëzimin e sistemeve open access, biblioteka e Universitetit ka instaluar falas Katalogun Online të Integruar, për menaxhimin e fondit të saj. UAMD është pjesë e Rrjetit Akademik Shqiptar, e cila i krijon mundësinë e aksesimit në Platformën e Bibliotekës Elektronike ULIBRARY si edhe në databazet elektronike si:</p> <p>https://op.europa.eu/, https://www.unrisd.org/, www.ebsco.com/, https://www.elgaronline.com/; https://msp.org/publications/journals/, https://onlinelibrary.Wiley.com/, https://librarianresources.taylorandfrancis.com.</p> <p>UAMD, ka një marrëveshje bashkëpunimi për aksesim pa pagesë në platformën universitare “Coursera”, e cila mundëson 4.000 kurse ndërkombëtare online, me mbi 200 universitete të huaja partnere.</p> <p><i>(Evidenca 20. Informacion për Bibliotekën online; Evidencë 11. Rregullorja e bibliotekës shkencore të universitetit “Aleksandër Moisiu” Durrës, 2019; https://uamd.edu.al/biblioteka-universitare/).</i></p>
Konkluzione	<i>Në lidhje me shkallën e përmbushjes së standardit, GVJ konstaton se Departamenti i Shkencave Politike ndonëse referon një literaturë të pasur tek studentët për të realizuar programin e</i>

	<p><i>studimit, duhet të shtojë literaturën e nevojshme fizike të përditësuar në bibliotekën e tij në mbështetje të mësimdhënies. Biblioteka ka pasur prurjet e fundit me libra fizik në vitin 2016. Mundësitë me literaturat online janë të pëlqyeshme, si për stafet akademike edhe për studentët e Masterit Shkencor. Aksesit në to është i njëjtë për të gjithë, si në mjediset e brendshme të UAMD, ashtu dhe në ato të jashtme të kampusit të ri universitar.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>DSHP administron të dhënat e studentëve nëpërmjet sistemit Pitagora dhe studentët informohen në mënyrë të vazhdueshme për oraret, lëndët, provimet, mundësitë që ata kanë për trajnime, mobilitete apo praktika profesionale. Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të një sërë dokumentesh, GVJ vlerëson se sekretaritetë disponojnë gjithë informacionin në lidhje me studentët, nga regjistrimi deri në diplomim nëpër regjistra të standardizuar për IAL me të dhëna të përditësuara nga gjeneralitetet si datëlindja, atësia, deri tek shkolla e mesme nga kanë ardhur, data dhe viti i regjistrimit në programin e studimit që ndjekin, notat, datën e ç’regjistrimit dhe transferimit për ata që ndërpresin studimet ose që transferohen nga IAL të tjera, datën e diplomimit dhe kontaktet.</p> <p><i>(Evidenca Nr.8 Manual për funksionimin e Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike; Evidenca 19 Të dhëna mbi studentët për programet e studimit në FSHPJ).</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në UAMD u njoh me bazën e të dhënave dhe dokumentacionin mbi personelin akademik, ndihmës akademik, personelin administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike”. Sektori i Burimeve Njerëzore disponon dosjet e të gjithë stafit akademik dhe administrativ që prej aplikimit të tyre. Dosjet përditësohen me çdo dokument të fituar nga anëtarët e stafit përgjatë punës së tyre dhe dokumenti shtohet në dosje <i>(p.sh një diplomë shtesë, një certifikatë, publikim/botim në revistë</i></p>

<p>programit.</p>	<p><i>shkencore etj</i>). Çdo përdorues personel akademik dhe administrativ i angazhuar në programin bachelor në Shkenca Politike ka akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me aktivitetin e tij në sistemin Pitagora.</p> <p><i>(Evidenca Nr.7 Rregullore Drejtoria e BNJJ; Evidenca 14. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike; Evidenca Nr.16 Personeli Akademik në SHP; https://uamd.pitagora.rash.al/login).</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi Pitagora ofron akses të dedikuar për të dhënat që kanë lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Studentët kanë akses në kurrikulat e tyre, vlerësimin për kurset e frekuentuara dhe provimet, regjistrimin dhe të dhënat e orarit mësimor etj. - Personeli akademik ka akses në regjistrat e seksioneve që mbulon, procesverbalet e vlerësimit të studentëve, orarin mësimor etj. - Sekretaria mësimore ka akses të dedikuar për orarin mësimor, listat e studentëve të regjistruar në orar, të dhënat e studentëve dhe vlerësimet e tyre, të dhënat për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie etj. - Dega ekonomike ka akses në të dhënat e studentëve përsa i përket tarifave të studimit. (https://uamd.pitagora.rash.al/login)
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Të dhënat garantojnë si për personelin dhe studentët në mënyrë fizike dhe virtuale nëpërmjet zonës së studentit në websitin e UAMD dhe në sistemin e përdorimit elektronik për stafin akademik, për fakultetet dhe programet e studimit që ofrohen. GVJ konfirmoi nga stafet akademike dhe studentët për shkëmbimin e informacionit në sistemin e përdorimit elektronik për literaturat, notat, etj. Platforma Pitagora mundëson komunikimin interaktiv dhe transmetimin e informacionit ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, nga lektori te studenti në konfidencialitet të plotë.</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Platforma Pitagora mundëson komunikimin dhe garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrative, transmetimin e informacionit ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, nga sekretaritë tek Përgjegjësi i Departamentit dhe zv. Dekani, duke siguruar komunikimin në kohë reale.</p> <p><i>(Evidencë 4. Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës; https://uamd.pitagora.rash.al/login</i></p> <p><i>Evidencë 33. vkm_nr_88_date_1422018_-_krijimi_rash_230316_113123)</i></p>



Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ gjatë vizitës në UAMD, konstatoi se sistemi i menaxhimit garanton informacionet mbi aktivitetet akademike e administrative në kohë reale, të cilat mundësojnë monitorimin dhe raportime individuale. Faqja web www.uamd.edu.al përmban të gjitha informacionet e përditësuara mbi personalin akademik, programet e studimit, aktivitete, njoftime në gjuhën shqipe dhe disa janë të disponueshme edhe në gjuhën angleze. https://www.uamd.edu.al/index.php/sq/fakulteti-i-shkencave-politike-juridike/			
Konkluzione	<i>GVJ gjykon se UAMD disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, janë të përditësuara në faqen e internet të UAMD www.uamd.edu.al</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Raporti financiar i UAMD nuk pasqyron kosto të veçanta për Departamentin e Shkencave Politike apo për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike”, por në nivel universiteti. Në përfundim të çdo viti akademik, njësitë kryesore të UAMD propozojnë planin strategjik ku parashikohen shpenzimet e nevojshme dhe të ardhurat, të cilat përpunohen nga administratori i UAMD i cili vlerëson mundësitë financiare të UAMD për të realizuar këto kërkesa dhe së bashku me zyrën e financës së UAMD, hartojnë planin strategjik financiar që i paraqitet për miratim bordit të administrimit. Raportet financiare në rang institucional tregojnë diversifikimin e të ardhurave. Evidenca mbi Të ardhurat dhe financimet e ndryshme 2016-2021 tregon që UAMD ka siguruar të ardhura nga disa burime, që nga pushteti vendor deri tek sponsorizimet nga fonde jo-publike. <i>(Evidencë 48. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 5 vitet e fundit). (Evidencë 49. Të dhënat financiare të ardhura dhe</i>

	<i>shpenzime Janar 2023).</i>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Plani financiar i UAMD si institucion që financohet nga buxheti i shtetit, përmban zërat sipas rregullave të një strukture kontabël ku përfshihen: Të ardhurat, të ndara në të ardhura nga tarifat e studentëve, nga shërbimet, nga projektet dhe donatorët. Tek Shpenzimet përfshihen që nga ato për investime, bibliotekën, pajisjet kompjuterike, projektet kërkimore deri tek pagat e personelit, ku fakti, realizimi është gjithmonë më i vogël sesa plani. Plani i financimit të programit të studimit përfshihet në planin financiar të Fakultetit të Shkencave Politike-Juridike dhe ky i fundit në atë të Universitetit. Nga evidencat e shqyrtuara gjatë vizitës në institucion dhe ato në faqen online të ASCAL, GVJ konfirmon se Plani mban të gjitha elementet dhe zërat specifikë për financimin e programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike”.</p> <p><i>(Evidencë 48. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 5 vitet e fundit).</i></p> <p><i>(Evidencë 49. Të dhënat financiare të ardhura dhe shpenzime Janar 2023;</i></p> <p><i>Evidencë 42. Raport Vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare për vitin 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidencë 45. Raport Vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare për vitin 2020-2021).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UAMD si institucion që financohet nga buxheti i shtetit, harton dhe zbaton planin vjetor të Degës së Auditimit të Brendshëm, duke e strukturuar në bazë të Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (Raporti i VB ka gabim referencën e këtij ligji: Ligjit Nr.10318, datë 16.09.2010 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”). Këto audite dëshmojnë efektivitetin financiar të institucionit.</p> <p><i>(Evidencë 42. Raport Vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare për vitin 2021-2022).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Institucioni disponon raportet financiare për çdo vit akademik të cilat u bëhen me dije edhe njësisë bazë si Departamenti i Shkencave Politike, si njësisia bazë përgjegjëse për programin e studimit Bachelor në SHP.</p> <p><i>(Evidencë 42. Raport Vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare për vitin 2021-2022).</i></p> <p><i>(Evidencë 45. Raport Vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare për vitin 2020-2021).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni</p>	<p>GVJ duke e vlerësuar evidencat financiare dhe nisur nga fakti që</p>

<p>garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Universiteti Aleksandër Moisiu” është IAL publik që financohet nga buxheti i shtetit, tarifrat e studentëve, shërbimet, projektet kërkimore dhe në rastet e nevojave siguron sponsorizime nga donatorët, konkludon se UAMD e ka të garantuar qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit. Ky program është në mbyllje dhe institucioni ka planifikuar zëvendësimin e tij me një program tjetër bachelor në Shkenca Politike që është kryesisht bashkëpunim me universitetet italiane.</p> <p><i>(Evidencë 34. Vendimet për tarifrat dhe pagesat studentore;</i></p> <p><i>Evidencë 48. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 5 vitet e fundit;</i></p> <p><i>Evidencë 42. Raport Vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare për vitin 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidencë 45. Raport Vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare për vitin 2020-2021).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ duke e vlerësuar nga këndvështrimi i një institucioni që mbështetet nga buxheti i shtetit, vlerëson se UAMD garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve. Pavarësisht se numri i studentëve në Bachelor në “Shkenca Politike” ka pasur rënie të ndjeshme, për rrjedhojë edhe të ardhurat nga tarifrat studentore, UAMD ka diversifikuar burimet përmes projekteve kërkimore dhe sponsorizimeve nga subjekte vendase, publike dhe jo publike.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	--

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin,

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>GVJ, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe verifikimit të të dhënave të studentëve vërteton se ato janë në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Asrimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM Nr.436, datë 03.06.2020 “Për përcaktimin e kriterit të notës mesatare për pranimin e kandidatëve në programet e studimeve të ciklit të parë dhe në programet e ciklit të dytë. Po ashtu, edhe aktet rregullatore të institucionit të tilla si: Statuti dhe Rregulloret apo edhe vendimet e Senatit pasqyrojnë procedurat sipas legjislacionit në fuqi dhe zbatohen edhe nga DSHP. Kriteret pranuese në programin bachelor në “Shkenca Politike”, si nota mesatare, diploma e shkollës së mesme, si dhe propozimi për numrin e kuotave kalojnë për miratim nga Departamenti në dekanat, rektorat, senat akademik, MAS dhe janë të publikuara në faqen elektronike të UAMD si dhe në portalin U-Albania për të gjithë maturantët. Bazuar në udhëzimet nga MASR, zbatohen edhe rregullat për kalimin nga një vit në tjetrin, sipas krediteve të fituara, apo pranimet e transferimet nga IAL të tjera. Gjatë këtij procesi aplikantët kanë edhe mundësinë e ankimit, ndonëse nuk ka pasur raste për programet e studimit Bachelor të DSHP.</p> <p><i>(Evidencë 27. Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studenteve 2022;</i></p> <p><i>Evidencë 30. Vendim Senati për Kuotat 2022;</i></p> <p><i>Evidencë 4. Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës).</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e UAMD bazohen në udhëzimet dhe periudhat e përcaktuara nga MASR dhe dokumentacionin e kërkuar formalisht. Për transparencë i gjithë ky proces aplikohet në sistemin U-Albania ku çdo aplikant mund të informohet për rezultatin dhe ecurinë e aplikimit të tij. Studentët fitues përzgjidhen duke u bazuar vetëm në kriteret e përcaktuara në vendimin e Senatit Akademik të UAMD duke siguruar një vlerësim korrekt dhe të barabartë për të gjithë aplikantët.</p> <p><i>(Evidencë 27. Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studenteve 2022;</i></p> <p><i>Evidencë 30. Vendim Senati për Kuotat 2022;</i></p> <p><i>Evidencë 4. Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti</p>	<p>Programi i transparencës në Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës mbështetet në parimin e së drejtës për informim për</p>

<p>akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>kriteret e përgjithshme e të veçanta të çdo programi studimi që u bëhen të ditura studentit që në momentin e regjistrimit. Çdo fillim viti akademik, DSHP propozon kriteret për përzgjedhjen e studentëve në programin bachelor në Shkenca Politike. Këto kritere pranimi miratohen me vendim të Senatit Akademik të UAMD, bazuar në propozimet e DSHP dhe FSHPJ, dhe publikohen në faqen online të UAMD. Faqja online e UAMD dhe broshurat informative ofrojnë informacione mbi programin e studimit, kriteret e pranimit dhe mënyrën e aplikimit. GVJ i konfirmoi këto gjatë takimit në institucion me stafin e departamentit dhe studentët.</p> <p><i>(Evidencë 40. Buletini i aktiviteteve të FSHPJ; https://www.uamd.edu.al)</i></p> <p><i>Evidencë 27. Vendim Senati për Kriteret e Pranimit te Studenteve 2022;</i></p> <p><i>Evidencë 30. Vendim Senati për Kuota t 2022;</i></p> <p><i>Evidencë 4. Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës).</i></p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Referuar dokumenteve si Statuti i UAMD, Rregulloreve, Kodi i Etikës së Universitetit, si dhe vendimeve apo udhëzimeve në lidhje me kuotat, tarifat e studimit, kriteret e pranimeve të studentëve, procedurave të transferimit të krediteve, ato janë të përcaktuara qartë në AKTET rregullatore të UAMD. GVJ konfirmon se këto kritere, si të gjitha vendimet e senatit, publikohen në faqen elektronike zyrtare të UAMD. Gjithashtu njoftimet për kriteret pranuese, kërkesat e veçanta dhe afatet publikohen edhe në rrjetet sociale zyrtare të UAMD. Ato janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku, sikurse u konfirmua nga biseda me studentët në UAMD.</p> <p><i>(Evidencë 1. Statuti UAMD;</i></p> <p><i>Evidencë 4. Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës; https://www.facebook.com/uamdofficial/)</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Për programin Bachelor në “Shkenca Politike”, institucioni informon të interesuarit, përpara fillimit të çdo viti akademik, për kriteret dhe procedurat që kryhen në përzgjedhjen e aplikantëve. Faqja online e UAMD dhe broshurat informative ofrojnë informacione mbi programin e studimit, kriteret e përgjithshme e të veçanta të pranimit në programin e studimit dhe mënyrën e aplikimit. GVJ i konfirmoi këto gjatë takimit në institucion me stafin e departamentit dhe studentët. (https://www.uamd.edu.al)</p> <p><i>Evidencë 27. Vendim Senati për Kriteret e Pranimit te Studenteve 2022).</i></p>

<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ duke iu referuar vendimeve të Senatit për kriteret e pranimit, konstaton se përfshihen edhe lehtësira si bursa për kategori të veçanta si për studentë nga pakicat kombëtare, me status jetimi si dhe personat me aftësi të veçanta. Për studentët me aftësi të veçanta në godinat e UAMD-së është vënë në dispozicion infrastruktura e nevojshme si ashensore për të lehtësuar lëvizjen e tyre, të cilët e provoi edhe GVJ gjatë vizitës në institucion. Po ashtu, UAMD ka Rregulloren e Brendshme për Trajtimin e Studentëve me aftësi të Kufizuara.</p> <p><i>(Evidencë 34. Vendimet për tarifatat dhe pagesat studentore; Evidencë 27. Vendim Senati për Kriteret e Pranimit të Studenteve 2022; Evidencë 30. Vendim Senati për Kuotat 2022).</i></p>			
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Për çdo vit akademik, UAMD publikon edhe kriteret e programit Bachelor në “Shkenca Politike” për studentë të huaj që shfaqin interes. Kriteret përzgjedhëse janë të njëjtat me aplikantët brenda vendit, por kuotat janë të dedikuara për këto kategori dhe aplikimet bëhen sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit.</p>			
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Mbështetur në VKM-në Nr. 39, datë 23.01.2019 “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore, për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, të ndryshuar, UAMD ka hartuar dhe publikuar kriteret për kategori të veçanta. Konkretisht, studentët që vijnë nga shtresa sociale “rome-egjiptiane” të cilët ndjekin studimet në Bachelor përfitojnë reduktim të tarifës vjetore të shkollimit në masën 100%. Në faqen zyrtare të UAMD https://old.uamd.edu.al/sq/informacion-per-bursat-per-studentet-bachelor-dhe-studentet-e-programeve-profesionale/</p> <p><i>(Evidencë 34. Vendimet për tarifatat dhe pagesat studentore).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se UAMD harton dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Bachelor. Institucioni harton politika të ndihmës për shtresa në nevojë deri në 100% reduktim i tarifës dhe për të rritur cilësinë me mbështetje për studentët ekselentë. UAMD i bën këto publike në faqen zyrtare dhe buletine informative që ua ve në dispozicion përpara fillimit të çdo viti akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ nga biseda me studentët konfirmon se UAMD u siguron studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm që gjatë regjistrimit të tyre. Studentët që në kontaktin e pare me sekretarinë mësimore i informon ata në lidhje me kurrikulën, orarin, sistemin e krediteve për të kaluar nga një vit në tjetrin. Koordinator i programit bachelor në “Shkenca Politike” si dhe drejtuesit e DSHP organizojnë takime periodike me studentët e këtij programi për të ndjekur ecurinë e tyre dhe për t’i informuar për çdo kërkesë dhe afat që ndikon në përparimin e tyre akademik.</p> <p><i>(Evidencë 23. Vendimi për emërimin e Koordinatorit të programit të studimit; Evidencë 4. Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës;</i></p> <p><i>Evidencë 5. Rregullore programit SHP).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve nga studime të mëparshme janë të pasqyruara në rregulloren e UAMD dhe zbatohen sikurse u provua nga biseda e GVJ me studentët, ku A.Z konfirmoi se në lidhje me mundësinë e transferimit të krediteve ai e kishte provuar pasi u kthye nga një eksperiencë një semestër me Erasmus+ për procedurat që u ndoqën në konvertimin e krediteve. Tani që kanë miratuar diplomë të dyfishtë me Universitetin e Gjenovës, Itali, çdo boshllëk i evdientuar në kuadrin rregulator do të plotësohet më së miri.</p> <p><i>(Evidencë 4. Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës; Evidencë 5. Rregullore programit SHP).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për vlerësimin të dijeve e aftësive të studentëve janë të përcaktuara në Rregulloren e UAMD dhe Rregulloren e programit SHP sipas sistemit të krediteve. Studentët njihen me procedurat e vlerësimit të dijeve që në javën e parë të mësimin për studentët e vitit të pare, si dhe informohen nga personeli akademik gjatë orës së parë të çdo lënde që ata frekuentojnë për çdo vit. Informimi i studentëve për të gjithë informacionin e mësipërm realizohet me komunikim të drejtpërdrejtë në auditor duke sqaruar çdo paqartësi që studentët mund të kenë. <i>(Evidencë 4. Rregullore e Universitetit Aleksandër</i></p>

	<i>Moisiu Durrës; Evidencë 5. Rregullore programit SHP).</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në rregulloren e programit të studimit dhe të UAMD janë të përcaktuara kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit, ndonëse për Bachelorin studentët japin provimin final. <i>(Evidencë 5. Rregullore programit SHP; Evidenca 9. Modeli i Diplomës; Evidencë 41. Urdhër Komision Diplomimi).</i>			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	UAMD - DSHP në mënyrë periodike organizon panairt e përvitshme në mjediset e universitetit ku ftohen aktorët lokalë. Po ashtu, edhe në qendrat e qyteteve kryesore ku janë prurjet më të mëdha të studentëve të Bachelorit, organizohen panairt për promovimin e programit të studimit. UAMD organizon ditë orientuese për maturantët ku ata mund të vizitojnë ambjentet universitare të FSHPJ, takime informuese online me grupe maturanësh në rang gjimnazesh. Informacionet janë të shpallura në broshura informative dhe katalogut studentor, si dhe në faqen online të UAMD. (https://uamd.edu.al ; https://www.facebook.com/FSHPJDurres/).			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UAMD u siguron studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimit në fillim të çdo viti akademik. UAMD ka përcaktuar rregullore dhe vendime senati për kriteret të detajuara për përparimin akademik, transferimin dhe njohjen e krediteve të fituara më parë, vlerësimin e dijeve deri në përfundim me rregulloren e provimeve e diplomimit. Informimi bëhet në fillim të vitit akademik përmes takimeve të organizuara me studentët, nga Koordinatori dhe stafi i Departamentit, kurse titullarët e lëndëve u shpjegojnë që ditën e parë të prezantimit të programit të lëndës mënyrën e vlerësimit. Po ashtu, broshurat dhe faqja online e UAMD sigurojnë informacione të detajuara edhe për tërheqjen e kandidatëve të mundshëm, me të cilët komunikohet nga afër në panairt e organizuara dhe ditët informative në qytetet dhe shkollat e mesme të vendit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të

Duray *Mos*

hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Statuti dhe Rregullorja e UAMD, Katalogu i programeve të Studimit, Guida Studentore, janë dokumente me të cilat studentët informohen në mënyrë të hollësishme për të gjithë komponentët e programit të studimit. Çdo student në momentin e regjistrimit në programin bachelor në “Shkenca Politike” merr nga sekretaria mësimore kurrikulën e programit të studimit ku pasqyrohet qartë lista e lëndëve, kreditet për çdo lëndë, shpërndarja e tyre sipas semestrave dhe tipologjisë së moduleve dhe kohëzgjatjen sipas rregullave të përcaktuara në UAMD. <i>(Evidencë 5. Rregullore e programit SHP;</i> <i>Evidencë 8. Manual për funksionimin e sekretarisë mesimore FSHPJ).</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në fillim të çdo lënde studentët marrin nga personeli akademik i kursit programin e lëndës ku përcaktohen qartë temat dhe shpërndarja e tyre përgjatë semestrit, periudha e provimeve, objektivat formues, mënyra e vlerësimit etj. Departamenti i Shkencave Politike dhe studentët i prezantuan GVJ gjatë vizitës në UAMD, se janë të familjarizuar me lëndët, përmbajtjen e syllabuseve dhe organizimit të veprimtarisë formuese që në fillim të studimeve. Përgjatë vitit, si pedagogët, koordinatori i programit të studimit dhe sekretaria mësimore iu vënë në dispozicion studentëve gjithë informacionin e kërkuar, një pjesë e të cilit është në faqen zyrtare online të UAMD. <i>(Evidencë 5. Rregullore e programit SHP;</i> <i>Evidencë 12. Syllabuset e lendeve;</i> <i>Evidencë 23. Vendim për emërimin e koordinatorit të programit të studimit).</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nga takimi i GVJ me specialisten e zyrës së Këshillimit dhe Karrierës, vlerësojmë se kjo strukturë përgjegjëse informon dhe këshillon studentët për mundësitë e praktikavë mësimore, rritjen e kapaciteteve profesionale dhe mbi mundësitë të punësimit. UAMD e ka formalizuar këtë veprimtari në Rregulloren e Sektorit të Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës.
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën,	Stafi i UAMD i vuri në dispozicion GVJ informacion të gjerë dhe të përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor. Po ashtu GVJ vizitoi mjediset për instrumentet logjistike të mjaftueshme për zhvillimin e procesit mësimor në Masterin Shkencor MND, i cili nuk kërkon ndonjë logjistikë dhe

infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	infrastrukturë të sofistikuar. Informacioni mbi to është lehtësisht i aksesueshëm për studentët nëpërmjet Departamentit të Shkencave Politike dhe kanaleve të ndryshme të komunikimit online nga UAMD. (Evidencë 14. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike).			
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	GVJ gjatë vizitës në UAMD konfirmoi se sistemi i brendshëm i menaxhimit të informacionit mundësohet nga platformat përkatëse që u siguron studentëve informacionin e detajuar lidhur me programin e studimit, i aksesueshëm lehtësisht kudo që ata ndodhen, breanda apo jashtë UAMD. Informacioni në lidhje me programin e studimit u ofrohet studentëve personalisht me komunikim të drejtpërdrejtë nga sekretaria mësimore. Gjithashtu ky informacion është i aksesueshëm edhe në distancë pasi është i publikuar në faqen elektronike zyrtare të UAMD si dhe në sistemin Pitagora (Evidencë 8. Manual për funksionimin e sekretarisë mesimore FSHPJ).			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UAMD vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit. Sistemit të brendshëm të menaxhimit të informacionit, i lehtësuar nga platformat përkatëse si Pitagora, i ofron studentëve informacion të detajuar e të përditësuar lidhur me programin e studimit, i aksesueshëm lehtësisht kudo që ata ndodhen.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	UAMD, si institucion publik i arsimit të lartë, respekton detyrimin për të raportuar periodikisht në Ministrinë e Arsimit të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve. GVJ e konfirmon këtë pas shqyrtimit të evidencave të vena në dispozicion nga Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike. Kjo zyrë ka përgjegjësinë të mbledhi të dhëna statistikore vjetore lidhur me numrin e studentëve aktualë dhe atyre të diplomuar në programin e studimit. Numri i studentëve të

	<p>regjistruar në këtë program studimi për tre vite akademike është si më poshtë vijon:</p> <p>v.a. 2020-2021 26 studentë</p> <p>v.a. 2021-2022 31 studentë</p> <p>v.a. 2022-2023 39 studentë</p> <p><i>(Evidencë 8. Manual për funksionimin e sekretarisë mesimore FSHPJ; Evidencë 19. Të dhëna mbi studentet për programet e studimit në FSHPJ).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>GVJ u njoh me statistika vjetore mbi numrin e studentëve të cilët janë regjistruar në programin e studimit nga sekretaria mesimore e cila i disponon në regjistrat themeltar sipas formateve të MAS, ashtu dhe në format elektronik. Gjithashtu të dhënat dhe statistikat mund të përpunohen edhe nga sistemi Pitagora që po aplikon UAMD. Të dhënat përditësohen me tërheqjet apo largimet para përfundimit të programit, deri tek diplomimet apo ata që nuk i kanë përfunduar ende studimet me sukses atë vit akademik (Evidenca Nr.8 Manual i funksionimit të Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike; Evidenca 19. Të dhëna mbi studentet për programet e studimit në FSHPJ).</p>
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>GVJ provoi gjatë vizitës në UAMD se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen nga Sekretaria Mësimore e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, të cilat përftohen edhe nga sistemi Pitagora. Të dhënat statistikore përdoren kryesisht nga koordinatori i programit të studimit dhe drejtuesit e FSHPJ. Informimi i drejtuesve të FSHPJ dhe i personave të autorizuar realizohet me anë të sistemit të brendshëm të komunikimit të UAMD. Ato mbeten konfidenciale dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. (Evidenca Nr.8 Manual i funksionimit të Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike; Evidenca 19. Të dhëna mbi studentet për programet e studimit në FSHPJ).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mesimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen</p>	<p>GVJ pasi shqyrtoi aktet e nxjerra nga UAMD si Rregullore, Manuale, Udhëzime, si dhe referuar sistemit të brendshëm të menaxhimit të të dhënave statistikore të studentëve, vlerëson se Departamenti i Shkencave Politike i ka të pasqyruara këto në raportet periodike të tij për çdo vit akademik mbi veprimtarinë e tyre. Institucioni nëpërmjet sistemit të brendshëm të informacionit mundëson menaxhimin e të dhënave statistikore të studentëve, duke respektuar konfidencialitetin dhe duke lejuar verifikimin e tyre në kohë reale prej personave të autorizuar bazuar në Statutin dhe</p>

dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	Rregulloren e UAMD (<i>Evidencë 1. Statuti UAMD; Evidencë 4. Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës; Evidenca Nr.8 Manual i funksionimit të Sekretarisë Mësimore në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike</i>).			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	<p>GVJ nga biseda me Departamentin e Shkencave Politike vlerëson se ata e kishin në vëmendje tendencën në rënie të numrit të studentëve në Bachelor, që gjatë periudhës në shqyrtim ka pasur tendencë rënie, nga 56 në vitin akademik 2019-2020 në 26 studentë një vit më pas dhe pastaj 31 studentë në vitin akademik 2021-2022. Departamenti i Shkencave Politike harton në bazë vjetore raporte analitike mbi mënyrën e kapërcimit të situatave kritike dhe ka vendosur të ofrojë një Diplomë Bachelori të Dyfishtë me Universitetin e Gjenovës, Itali. 70% e kurrikulës e ngjashme me Universitetin e Gjenovës, ku pritet të shkojnë deri në 10 studentë në vit që njohin në nivelin C1 gjuhën italiane.</p> <p>Duke gjykuar se perspektiva e punësimit të studentëve përbën një faktor kyç në këtë drejtim, Departamenti në kontakt të vazhdueshëm me Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës përpilon pyetësor me studentët e FSHPJ mbi orientimin e tyre në tregun e punës, duke analizuar e diskutuar mundësitë e përmirësimit të tyre. Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës angazhohet për të ndihmuar studentët që të bëjnë lidhjen më të mirë mes përvojës së tyre aktuale akademike dhe karrierës në punë, si dhe Departamentin në drejtimin e programit të studimit. Përsa i përket gjurmimit të studentëve pas diplomimit të tyre është përgjegjësi e ALUMNI. (<i>Evidencë 26. Analiza e Departamentit të Shkencave Politike 2019-2022; Evidencë 28. Pyetësor student UAMD</i>).</p>			
Konkluzione	<p>GVJ vlerëson se UAMD, si institucion publik i arsimit të lartë, respekton detyrimin për të raportuar periodikisht në Ministrinë e Arsimit të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, që sigurohen nga Sekretaria Mësimore. Departamenti në kontakt të vazhdueshëm me Zyrën e Këshillimit dhe Karrierës përpilon pyetësor me studentët mbi orientimin e tyre në tregun e punës, duke analizuar e diskutuar mundësitë për të ndihmuar studentët që të bëjnë lidhjen më të mirë mes përvojës së tyre aktuale akademike dhe karrierës në punë. ALUMNI evidenton të dhëna të punësimit të tyre pas diplomimit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson se Rregullorja e UAMD, si dhe Kodi i Etikës, parashikojnë që studentët të kenë përfaqësuesit e tyre në çdo organ vendimmarrës në UAMD, në raporte sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Ata janë anëtarë me të drejtë vote dhe me të drejta të barabarta me përfaqësuesit e personelit akademik. Studentët kanë përfaqësuesit e tyre në Senatin Akademik të UAMD, në komisionet zgjedhore në nivel institucional dhe njësie kryesore si dhe në komisione të përhershme si Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, ku zgjidhet edhe një student me mesatare të shkëlqyer mbi 9, si dhe një student në Këshillin e Etikës. <i>(Evidenca 4. Rregullore UAMD; Evidence 52. Kodi i Etikës).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga biseda e GVJ me studentët del qartë se ata janë të familjarizuar dhe të angazhuar me çfarë aktivitetesh zhvillohen në Departamentin e Shkencave Politike dhe UAMD. Pjesëmarrja e studentëve në vendimmarrjen e Departamentit realizohet kur ata ftohen në mbledhje ku ka për tu marrë ndonjë vendim që i ndikon ata. Rëndësia e angazhimit real të studentëve në vlerësimin e procesit akademik vlerësohej pozitivisht nga stafi akademik dhe drejtuesit që reflektonin rezultatet e anketimit të tyre. Konkretisht studentët kërkonin që pedagogët të përdornin më shumë videoprojektorë dhe power point, sepse për ta lenda bëhej më tërheqëse. Po kompjuterat e videoprojektorët nuk ishin në disa auditore. Pedagogët i përfshinin në projektet e tyre kërkimore, disa pedagoge e evidentuan këtë gjatë bisedës me ta.</p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>GVJ pas bisedës me stafin e DSHP gjykon se ata në diskutimet në mbledhje departamenti, apo me pyetësorët që organizohen nga Njësita e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, apo secili pedagog veçmas merrte opinionin e studentëve në përfundim të çdo lënde për përmirësime të programit të studimit. Ndryshimi i kurrikulave për këtë program studimi është realizuar në mënyrë periodike çdo 5 vjet, në 2019 dhe tani në 2023 me diplomën e dyfishtë me Univesitetin e Gjenovës. Opinioni i studentëve është reflektuar në përshtatjen e mësimdhënies, orareve, shpërndarjes së provimeve etj. Ndryshimet afatshkurtëra deri në 20% në programin e studimit reflektohen çdo vit në syllabuset e lëndëve. <i>(Evidencë 4. Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës).</i></p>

<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmerinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>DSHP ka një mënyrë plotësisht transparente dhe të unifikuar të vlerësimit dhe të ballafaqimit të rezultateve. Personeli akademik ka detyrim të ballafaqojë rezultatet me studentët 72 orë nga realizimi i testimit dhe të sqarojë çdo paqartësi të tyre në lidhje me vlerësimin e testimit. Në rast se edhe pas ballafaqimit të rezultateve student ka të drejtë të kërkojë rishikimin e tezës jo më vonë se 48 orë nga marja e rezultateve. Rishikimi i tezës realizohet nga një komision i ngritur nga njësi bazë që mbulon lëndën në prezencë të studentit dhe personelit akademik të kursit. Komisioni vendos për vlerësimin përfundimtar. Por studentët treguan se profesorët ishin të mirëkuptueshëm për pretendimet e tyre dhe nuk kishte dale nevoja për ngritje komisionesh shtesë. (Evidencë 4. Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës).</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se standardi përmbushet plotësisht bazuar në argumentet e evidentuara në pjesën përshkrimore. Studentëve u mundësohet pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes si nga UAMD dhe më konkretisht nga Departamenti i Shkencave Politike. Ata ftohen në mbledhjet e Departamentit, kryejne pyetësorë për procesin e vlerësimit të programit të studimit, si dhe në fund të çdo lende. Studentët e kanë të qartë edhe mundësinë e ankimimit të rezultatit sipas rregulloreve të UAMD, ndonëse ata kishin gjetur mirëkuptimin nga ana e pedagogut përgjegjës në rastet e përmirësimit të notës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ vlerëson se UAMD ka një dokumentacion që detajon kërkesat ligjore për përcaktimin e procedurave e strukturave të posaçme për informimin, orientimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve. GVJ pati takim në UAMD me sektorin e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës, që është struktura përgjegjëse dhe që zhvillon procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit dhe krijon Rrjetin Alumni për mundësi bashkëpunimi me kompani për praktikant dhe punësimin e studentëve. Alumni organizon aktivitete</p>



	<p>për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MASR të dhëna statistikore, zhvillon komunikimin efektiv dhe etik me studentët dhe të tjerët.</p> <p><i>(Evidencë 14. Rregullore e Drejtorisë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi i GVJ me Departamentin dhe NJSBC konkludohet se UAMD ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin dhe tërheqjen e mendimeve dhe ideve të studentëve lidhur me çështje të procesit mësimor e programet e studimit. Departamenti orienton politikat e tutorialit për mbarëvajtjen e procesit mësimor, kurse Zyra e Këshillimit, Alumnit dhe Karrierës ofron shërbime këshillimore dhe orientuese në dobi të karrierës së studentëve, kurse Këshilli Studentor, mundëson përcjelljen e informacioneve të studentëve në strukturat vendimarrëse të UAMD dhe anasjelltas.</p> <p><i>(Evidenca Nr.6. Rregullore e NJSBC të UAMD; Evidenca Nr.4. Rregulloren e UAMD; Evidenca Nr.5. Rregullore e programit SHP).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Zyra e Këshillimit, Alumnit dhe Karrierës orienton studentët gjatë gjithë ciklit të studimit për mundësitë e praktikave mësimore dhe mundësitë e punësimit përmes kontakteve individuale ose trajnimeve në grup. Zyra vepron edhe duke aktivizuar rrjetet alumni të të diplomuarve për tu sjellë studentëve modele positive. Rrjeti Alumni krijon mundësi bashkëpunimi me kompani për ofrimin e praktikave dhe punësimit për studentët, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MASR të dhëna statistikore dhe të tjerë. Nëpërmjet ofrimit të mundësive për praktikat profesionale duke përdorur marrëveshjet e bashkëpunimit të nënshkruara nga ana e institucionit, studentëve ju jepet edhe një mundësi punësimi bazuar në aftësitë që ata demonstrojnë.</p> <p><i>(Evidenca Nr.4. Rregulloren e UAMD; Evidenca Nr.5. Rregullore e programit SHP; Evidenca 37. Marrëveshjet e bashkëpunimit UAMD).</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion</p>	<p>Zyra e Komunikimit, Alumnit dhe Karrierës mban kontakte me studentët edhe pas diplomimit duke aktivizuar edhe rrjetin alumni. Nga biseda e GVJ me Zyrën e Këshillimit, Alumnit dhe Karrierës, konfirmojmë se specialistja e saj mban kontakte të vazhdueshme me studentët edhe pas diplomimit, duke aktivizuar rrjetin alumni. Rrjeti Alumni krijon mundësi shpërndarje informacioni për mundësi praktikash dhe punësimi për studentët, organizon aktivitete për studentët si trajnime, seminare, etj. Të dhëna të tilla</p>

studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	vihen në dispozicion të drejtuesve të institucionit. (Evidenca Nr.4. Rregulloren e UAMD; Evidenca 37. Marrëveshjet e bashkëpunimit UAMD).			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UAMD ka një dokumentacion që detajon kërkesat ligjore për përcaktimin e procedurave e strukturave të posaçme për informimin, orientimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve. Krahas dokumentacionit, ka struktura funksionale. Në sferën akademike, Departamenti dhe stafet akademike ndihmojnë për të orientuar e bashkëpunuar ngushtë me studentët, veçanërisht koordinatori i programit. Zyra e Këshillimit, Alumnit dhe Karrierës ofron shërbime këshillimore dhe orientuese në dobi të karrierës së studentëve dhe të punësimit. Këshilli Studentor, i cili mundëson përcjelljen e informacioneve të studentëve në strukturat vendimarrëse të UAMD dhe anasjelltas. Sekretaritetë sigurojnë shkëmbimin e informacionit me studentët për notat, kreditet, transferimet, etj.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Vlerësimi i brendshëm i cilësisë mbështetet në manualin për sistemin e brendshëm për sigurimin e cilësisë në UAMD, si dhe atë të Fakultetit të Shkencave Politike Juridike të ngritur më 2018 (Evidencë 10. Urdhër NJSBC FSHP). UAMD përdor një udhëzues për personelin akademik për metodat e ndryshme dhe inovative të mësimdhënies bazuar në rregulloren e Qendrës për Edukim në Vazhdim. Kjo njësi organizon gjatë vitit akademik trajnime për personelin akademik në lidhje me metodat inovative në mësimdhënie si dhe për rritjen e aftësive pedagogjike të personelit

	<p>akademik. Shqyrtimi nga GVJ i formateve të syllabuseve tregon që stafet akademike përcaktojnë një larmi metodash mësimdhënie, në varësi të subjekteve që mbulojnë.</p> <p><i>(Evidenca Nr.6 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;</i></p> <p><i>Evidencë 10. Urdhër NJSBC FSHP</i></p> <p><i>Evidenca 12. Syllabuset e lëndëve;</i></p> <p><i>Evidencë 21. Rregullore Qendra për Edukim në Vazhdim 2022).</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>NJSBC i vuri në dispozicion GVJ gjatë takimit në UAMD formularë të aplikuar në funksion të sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së programit të studimit. Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë dhe Koordinatori i programit vlerësojnë periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik si përmes formularëve të vetëvlerësimit, të vlerësimit nga studentët për çdo lëndë në fund të semestrit, sikurse edhe mbi bazën e treguesve të aktivitetit të tyre shkencor.</p> <p><i>(Evidenca Nr.6 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;</i></p> <p><i>Evidencë 28. Pyetesor Student UAMD;</i></p> <p><i>Evidencë 31 Formular i vetëvlerësimit të performances së personelit akademik).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë vlerëson periodikisht aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik përmes formularëve të vlerësimit nga studentët, krahas vlerësimit që bën vetë pedagogu i lëndës për çdo lëndë në fund të semestrit. Një tjetër pyetësor që angazhon studentët është anketimi gjithëpërfshirës vjetor në lidhje me opinionin e tyre të përgjithshëm për eksperiencën e tyre gjatë kohëzgjatjes së studimeve. Rezultatet e këtij anketimi bëhen publike nga NJSBC në faqen elektronike zyrtare të UAMD.</p> <p><i>(Evidenca Nr.6 Rregullore për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;</i></p> <p><i>Evidencë 28. Pyetesor Student UAMD;</i></p> <p><i>Evidenca 25. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 2021-2022).</i></p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike</p>	<p>GVJ nga biseda me përgjegjësin e Departamentit SHP konstatoi se rezultatet e anketimit i dërgohen të grupuara drejtuesve të njësive bazë dhe njësive kryesore, të cilët ia bëjnë të njohura çdo anëtar të personelit akademik veçmas dhe problematikat kryesore në mbledhje departamenti. Ata informohet me anë të postës</p>

rezultatet e vlerësimit.	elektronike në lidhje me rezultatet për këtë anketim. <i>(Evidenca 25. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 2021-2022).</i>			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Mbi bazën e analizës së rezultateve të anketimit, departamenti nxjerr problematikat dhe reagon për përmirësimin e tyre. Promovimi i përmirësimit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor rezulton nga bisedat me stafin akademik dhe studentët, të cilët përfshihen në projektet e pedagogëve të cilët kanë avancuar në karrierën e tyre përmes gradave Doktor, Prof.Asoc. dhe Profesor. (Evidencë 31 Formular i vetëvlerësimit të performances së personelit akademik; Evidencë 50. Analiza e pyetësorëve (Student, Staf Akademik, Staf administrativ) 2021).			
Konkluzione	<i>GVJ vlerëson se UAMD ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies, ka krijuar strukturat përgjegjëse si NJSBC dhe aktet rregullative mbi bazën e të cilave garanton zhvillimin e metodave interaktive dhe monitorimin e vazhdueshëm të cilësisë së procesit mësimor. Në procesin e vlerësimit përfshihen edhe studentët, pyetësorët dhe formularët e vlerësimit, stafet akademike dhe NJSBC.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ vlerëson se UAMD ka politika dhe procedura të miratuara në Rregulloren e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, ku përcaktohen edhe strukturat si njësi përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë si Drejtoria e Kurrikulave & Standarteve të Cilësisë. NJSBC është ngritur edhe në nivel fakulteti për FSHPJ në 2018 që tregon për vemendjen e shtuar ndaj respektimit të kërkesave ligjore në fuqi për rritjen e cilësisë në arsim. <i>(Evidencë 4. Rregullore e Universitetit Aleksandër Moisiu Durrës</i> <i>Evidencë 6. Rregullore për Funkcionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;</i>

<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p><i>Evidencë 10. Urdhër NJSBC FSHP).</i></p> <p>NJBSC në nivel institucional kryen funksionet e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë bazuar në manualët dhe treguesit e hartuar. NJBSC në proceset e vlerësimit të brendshëm të cilësisë ka përfshirë edhe studentët. Bazuar në rezultatet e pyetësorëve me studentët dhe vlerësimet e stafit akademik, si dhe në bashkëpunim me aktorë të komunitetit, si institucionet publike/ OSHC ku studentët zhvillojnë praktikatat, Departamenti ka qenë i nxitur për përmirësimet e nevojshme të programit të studimit. Po ashtu, përmes bashkëpunimeve me aktorë të jashtëm si universitetet me të cilat kanë projekte të përbashkëta, janë përmirësuar kurrikulat dhe syllabuset e lëndëve, sikurse doli nga biseda me drejtuesit dhe stafin akademik.</p> <p><i>(Evidencë 6. Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;</i></p> <p><i>Evidencë 10. Urdhër NJSBC FSHP).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UAMD përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Llojet e akreditimit, afatet dhe procedurat shprehen qartësisht në pjesën gjashtë të rregullores për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL dhe ka marrë Akreditim për 4 vite deri në Mars 2026. Departamenti i Shkencave Politike ka rishikuar programin e studimit duke realizuar një diplomë të dyfishtë me Universitetin e Gjenovës, Itali ku 70% e kurrikulës është përshtatur me këtë të fundit.</p> <p><i>(Evidencë nr.6. Rregullore për Funkzionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;</i></p> <p><i>Evidencë nr.25. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 2021-2022; Evidencë nr.3. Raporti periodik i vlerësimit të jashtëm institucional;</i></p> <p><i>Evidencë nr.26. Analiza e Dept. SHP 2019-2020;</i></p> <p><i>Evidenca 36. Raport vjetor për vitin akademik 2019-2020 FSHPJ).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Nga biseda me stafin dhe përgjegjësen e Departamentit të Shkencave Politike, si edhe me zv. Dekanen e Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, GVJ gjykon se institucioni përdor tregues të ndryshëm të qartë dhe të matshëm si për mësimdhënie edhe kërkim shkencor për vlerësimin e cilësisë. Ato pasqyrohen në raportet e NJSBC, në analizat vjetore të departamentit, në evidencat statistikore dhe në kontrollet nga drejtuesit e Fakultetit e</p>

Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit.

Departamentit për procesin mësimor. Pjesë e raportit vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë është edhe monitorimi i mësimdhënies, mësimnxënies, vlerësimit dhe kërkimit. Vlerësimi trajton si treguesit sasior ashtu edhe treguesit cilësor të aktivitetit të personelit akademik, njësisë bazë, si dhe të programit të studimit. Sipas kriterëve të standartizuara në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, UAMD mundëson dhe nxit stafet akademike dhe studentët të afirmohen më tej në pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare dhe Erasmus+.

(Evidencë nr.6. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;

Evidencë nr.25. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 2021-2022).

Konkluzione

GVJ bazuar në shqyrtimin e politikave, strukturave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, vlerëson se UAMD vepron në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe aktet rregullatore të veta për kryerjen e vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme, si për akreditimin institucional edhe atë të programit të studimit. Ndërsa vlerësimet e jashtme bëhen në bashkëpunim me ASCAL, vlerësimet e brendshme kryhen përmes një procesi të bashkëpunimit mes strukturave të brendshme si NJSBC, Departamentit të Shkencave Politike, studentëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm, me të cilët Departamenti ka marrëveshje për praktikën e studentëve dhe projekte. Metodatat janë të ndryshme, që nga pyetësorët, formularët e vetëvlerësimit të stafit akademik, të studentëve, diskutimet në Departament deri tek monitorimet nga drejtuesit e UAMD. Reflektimet pasqyrohen në raporte të cilat janë transparente për të gjithë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Standardi VI.3	
Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese	GVJ pas bisedës me stafin dhe përgjegjësën e Departamentit të Shkencave Politike, NJSBC dhe drejtuesin e Njësisë së Kurrikulave në UAMD konfirmon se ky program studimi ka

<p>formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>kaluar në procese shqyrtimi që me vendosjen e tij në vitin 2010. Rishikimi i lëndëve, i syllabuseve dhe sigurimi i stafeve akademike të përshtatshme, si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm për realizimin e tij kanë kaluar nga departamenti në organet vendimmarrëse. Këto procese janë të dokumentuara në procesverbalet e mbledhjeve dhe në raportet periodike vjetore të Departamentit të Shkencave Politike, të FSHPJ, të NJSBC ku pasqyrohen arritjet, problematikat dhe masat për kapërcimin e tyre për të siguruar përmirësimin e programit të studimit, cilësinë e mësimdhënies së pedagogëve dhe vleresimit të stafit akademik. UAMD ofron një infrastrukturë të përmirësuar mësimdhënie në kampusin e ri që ka rritur cilësinë e mësimdhënies. Monitorimi i realizimit me korrektësi të programit bachelor në “Shkenca Politike” realizohet në mënyrë të vazhdueshme nga koordinatori i programit dhe nga njësitë e mësipërme dhe u bëhen të njohura autoriteteve drejtuese të FSHPJ. Bazuar në këto të dhëna përcaktohen edhe objektivat e programit të studimit për vitin pasardhës akademik.</p> <p><i>(Evidencë nr.6. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;</i></p> <p><i>Evidencë nr. 25. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 2021-2022; Evidencë nr.26. Analiza e Dept. SHP 2019-2020;</i></p> <p><i>Evidenca 36. Raport vjetor për vitin akademik 2019-2020 FSHPJ).</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Çdo fillim viti akademik asambleja e personelit akademik të DSHP diskuton në lidhje me programet e studimit që mbulon duke përfshirë edhe programin bachelor në “Shkenca Politike” dhe ka propozuar ndryshimet e nevojshme, sikurse është rasti i diplomës së dyfishtë me Universitetin e Gjenovës, Itali, duke dokumentuar formalisht ndryshimet e bëra në kurrikulën e tij.</p> <p>Nga shqyrtimi i raporteve të vlerësimit, GVJ gjykon se ato përmbajnë analiza të të dhënave statistikore, të studentëve të rregjistruar dhe atyre të diplomuar, që në tre vitet e para të aplikimit të këtij program studimi kanë qenë në përputhje me pritshmëritë, p.sh. viti akademik 2019-2020 56 studentë të rregjistruar, nga të cilët u diplomuan 45 dhe ata që mbetën u diplomuan një vit më vonë, ku numri i të diplomuarve (46) është më i lartë sesa i të rregjistruarve (26). Vlerësohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje (nota mesatare), kalueshmëria e kurseve, përqindja e studentëve të diplomuar brenda kohëzgjatjes normale të programit, përqindja e punësimit të studentëve brenda profilit pas diplomimit.</p>

	<p>Po ashtu pasqyrohen rezultate e avancimit të stafit akademik, të pjesëmarrjes së tyre në veprimtari kërkimore shkencore, publikimeve dhe projekteve të Departamentit të Shkencave Politike, apo Fakultetit të Shkencave Politike Juridike.</p> <p><i>(Evidencë nr. 25. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidencë nr.26. Analiza e Dept. SHP 2019-2020;</i></p> <p><i>Evidenca 36. Raport vjetor për vitin akademik 2019-2020 FSHPJ).</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Vlerësimi i cilësisë së programit bachelor në “Shkenca Politike” realizohet si nga NJBSC e UAMD, nga ajo e FSHPJ, si dhe nga vetë Departamenti SHP. Në diskutimin e GVJ me stafin akademik u konstatua se në matjen e cilësisë së mësimdhënies për këtë program studimi përdoren metoda dhe instrumenta specifike, që nga format e vlerësimit të larmishm të përcaktuara nga pedagogët në syllabuset e lëndëve, të cilat janë teste me shkrim, prezantime me gojë në auditor, apo kërkohet punë e pavarur me projektet e kursit, si dhe me përfshirje në projektet kërkimore të pedagogut. Përtej këtij niveli të vlerësimit në auditor, në mënyrë që të sigurohet të mësuarit jo vetëm të koncepteve teorike, por edhe të lidhjes me analiza të situatave konkrete, gjatë kryerjes së praktikës, monitorimit të saj dhe finalizimit me raportet e studentëve. Për vlerësimin e programit bachelor në “Shkenca Poltike” përdoren të dhënat e ofruara nga sekretaria mësimore, monitorimi i realizimit të aktiviteteve të programit të studimit, opinioni i studentëve dhe personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie.</p> <p><i>(Evidencë 6. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;</i></p> <p><i>Evidencë nr. 25. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 2021-2022;</i></p> <p><i>Evidencë nr.26. Analiza e Dept. SHP 2019-2020;</i></p> <p><i>Evidenca 36. Raport vjetor për vitin akademik 2019-2020 FSHPJ).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e</p>	<p>Nga shqyrtimi i raporteve të NJSBC dhe bisedat me stafin dhe studentët, GVJ vlerëson instrumentat e përdorura për vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit. Këto përfshijnë metodat e tërthorta të NJSBC si sondazhe të opinioneve të studentëve aktualë dhe atyre të diplomuar, si dhe të institucioneve ku ata bëjnë praktikë, sikurse janë parashikuar në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të</p>

<p>intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>brendshëm të sigurimit të cilësisë, po ashtu në Rregulloren e UAMD.</p> <p><i>(Evidencë 6. Rregullore për Funksonimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;</i></p> <p><i>Evidencë nr. 25. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 2021-2022; Evidencë nr.26. Analiza e Dept. SHP 2019-2020;</i></p> <p><i>Evidenca 36. Raport vjetor për vitin akademik 2019-2020 (FSHPJ).</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se UAMD, ka siguruar vlerësimin periodik të jashtëm nga ASCAL për akreditimin institucional dhe atë të programit të studimit. Dept. ShP ka kryer vlerësimin e brendshëm dhe zbaton sistemin e brendshëm për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë përmes njësive të posaçme si NJSBC, Drejtoria e Kurrikulave dhe Koordinatorit të programit të studimit. UAMD ka ngritur njësi si NJSBC në nivel institucional dhe të FSHPJ dhe ka miratuar e zbaton rregulloren e saj për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë që pasqyrohet në raportet periodike. Po ashtu, Drejtoria e Kurrikulave monitoron programin e studimit për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxëniet, duke siguruar që syllabuset t'i kenë pasqyruar saktë këto komponentë dhe pedagogët t'i zbatojnë ato në mënyre rigoroze. Studentët përmes pyetësorëve sjellin vlerësimet e tyre për arritjen e synimeve të programit të studimit. Po ashtu, edhe përshtypjet e bashkëpunëtorëve të institucioneve ku studentët bëjnë praktikën, të evidentuara në raportet e vlerësimit të studentëve, konfirmojnë dijet që ata kanë marrë përmes këtij programi studimi.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni duhet

GVJ pasi shqyrtoi dokumentacionin si Statutin dhe Rregulloren e

<p>të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UAMD, si dhe Rregulloren e NJSBC, vlerëson se institucioni i ka të parashikuara politikat dhe procedurat e brendshme të sigurimit të cilësisë. Po ashtu, gjatë vizitës në institucion konfirmuam se këto politika zbatohen përmes një procesi të përfshirjes së strukturave të brendshme si NJSBC, Drjetoria e Kurrikulave, Departamenti me stafin e tij, edhe studentët apo aktorët e jashtëm. Programi i studimit është riorganizuar në vitin 2023 me ndryshimin e kurrikulës për një diplomë të dyfishtë me universitetin e Gjenovës si rezultat i konsultimit të departamentit dhe kërkesave të studentëve për përshtatshmërinë e tij me tregun e punës.</p> <p><i>(Evidenca Nr.4 Rregullore e UAMD;</i> <i>Evidenca Nr.6 Rregullore e NJSBC UAMD;</i> <i>Evidencë 5. Rregullore programit SHP).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>GVJ pas vizitës në institucion, bisedave me stafet akademike dhe administrative e studentët, si dhe shqyrtimit të dokumentacionit si Statutin e UAMD dhe Rregulloren e NJSBC, vlerëson se institucioni ka përcaktuar qartë detyrat për njësitë, stafet akademik dhe ndihmësakademike, studentët dhe institucionet me të cilat ka marrëveshje si aktorë të angazhuar për sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Detyrat konkrete janë të përcaktuara dhe të specifikuara në Rregulloren për funksionimin dhe organizimin e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë. NJSBC, në bashkëpunim me Departamentin e Shkencave Politike, duke kërkuar vlerësimet periodike të studentëve dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm. Në këtë kuadër, personeli akademik përgjegjës për mbikqyrjen e praktikave luan rol kyç në manaxhimin e marrëdhënieve midis aktorëve të brendshëm edhe të jashtëm në realizimin e praktikave mësimore dhe për të marrë një vlerësim nga ta për cilësinë e programit të studimit.</p> <p><i>(Evidenca Nr.4 Rregullore e UAMD;</i> <i>Evidencë Nr.5. Rregullore programit SHP;</i> <i>Evidenca Nr.6 Rregullore e NJSBC UAMD</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e</p>	<p>Nga vizita në institucion, GVJ konfirmon se në vlerësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit Bachelor në “Shkenca Politike” janë të përfshirë të gjithë aktorët e brendshëm të FSHPJ. Drejtuesit e FSHPJ dhe DSHP kanë rolin kryesor në vendimmarrjet që lidhen me programin e studimit; personeli akademik është i angazhuar në çdo komision monitorimi si dhe jep opinionin e tij për përshtatjet në kurrrikula dhe në pjesën akademike të programit të studimit. Studentët përfshihen në anketime të ndryshme ku shprehin opinionin e tyre si dhe grupe të</p>

<p>administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>veçanta ad hoc kanë edhe përfaqësuesin e tyre. Këto rregulla procedurale janë të sanksionuara në Statutin dhe Rregulloren e UAMD dhe të provuara edhe në RVB për këtë program studimi, ku ekipi përbëhet nga pedagogë të Departamentit, të stafit administrativ dhe studentë.</p> <p><i>(Evidenca Nr.4 Rregullore e UAMD;</i> <i>Evidenca Nr.6 Rregullore e NJSBC UAMD;</i> <i>Evidencë 5. Rregullore programit SHP;</i> <i>Evidencë 25. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 2021-2022).</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i raportit të vlerësimit GVJ konfirmon se ato respektojnë etikën dhe integritetin akademik të personelit të përfshirë në sigurimin e cilësisë në Departamentin e Shkencave Politike. Sikurse u diskutua me përgjegjësen e Departamentit dhe të NJSBC, për çdo vërejtje konkrete në adresë të stafit akademik që ka dalë nga procesi i vlerësimit, ata kontaktohen veçmas duke shmangur çdo keqkuptim për këtë proces. Po ashtu, edhe vlerësimet e studentëve janë anonime, për të siguruar çdo qëndrim negativ ndaj kritikave të tyre. Specifikisht këto standarde referohen në Rregulloren e NJSBC në UAMD dhe Kodin e Etikës.</p> <p><i>(Evidenca Nr.6 Rregullore e NJSBC UAMD;</i> <i>Evidencë 52. Kodi i Etikës).</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në procesin e vlerësimit për sigurimin e brendshëm të cilësisë, UAMD ka përfshirë edhe përfaqësuesit e institucioneve dhe aktorë të tjerë me të cilët ka marrëveshje bashkëpunimi, bazuar në Rregulloret ku përcaktohen kriteret të tilla të funksionimit të këtij sistemi. Bashkëpunëtorët apo ekspertët e jashtëm, të cilët në rastin e Departamentit të Shkencave Politike janë edhe të diplomuarit e tij, kanë dhënë vlerësimet e tyre si për praktikën e studentëve, ashtu edhe për tematikën të lidhura me programin e studimit gjatë aktivitetëve ku ata janë ftuar në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike dhe në Universitet. Këto vlerësime të bashkëpunëtorëve të institucioneve ku studentët bëjnë praktikën, të evidentuara në raportet e vlerësimit të studentëve, konfirmojnë dijet që ata kanë marrë përmes këtij programi studimi dhe shërbejnë për përmirësimin e tij.</p> <p><i>(Evidencë 6. Rregullore për Funksionimin dhe Organizimin e Sistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë;</i> <i>Evidencë 37. Marrëveshjet e bashkëpunimit).</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konfirmon se UAMD përfshin në proceset e SBC-së të programit të studimit njësitë akademike si NJSBC, Drejtorinë e</i></p>

	<p><i>Kurrikulave, Departamentin e Shkencave Politike, personelin akademik dhe ndihmësakademik, studentët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm me të cilët ka marrëveshje institucionale. Palët e interesuara si stafet akademike, ndihmës akademike, studentët apo të tjerë bashkëpunëtorë informohen në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre përmes takimeve, raporteve, aktiviteteve të organizuara në UAMD, ndonëse ato nuk janë bërë publike në faqen online të UAMD.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>GVJ gjykon se veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit Bachelor në “Shkenca Politike” janë bërë transparente në raportet me të cilat janë njohur stafet akademike, qoftë nëpër mbledhje apo njoftime me e-maile. Po ashtu, studentët informohen periudikisht për veprimtaritë në lidhje me programin e studimit dhe përmirësimin e cilësisë. Gjatë gjithë vitit akademik, koordinatori i programit bachelor në “Shkenca Politike” organizon takime periodike duke përshtatur orarin e takimit me procesin mësimor. Transparenca si parim saksionohet si në Statutin dhe në Rregulloren e UAMD.</p> <p><i>(Evidenca Nr.6 Rregullore e NJSBC UAMD;</i> <i>Evidencë 25. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 2021-2022; www.uamd.al).</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Nga analizat e raporteve vjetore për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë dhe familjarizimi i stafit akademik e administrativ me to, GVJ gjykon se rezultatet e vlerësimit të programit të studimit iu vihen në dispozicion personelit akademik dhe studentëve, ndonëse nuk janë të publikuara në faqen zyrtare të UAMD. Personeli akademik informohet nga drejtuesi i departamentit në mënyrë individuale, kurse problematikat shtrohen për diskutim në mbledhje departamenti. Nga takimi i GVJ me studentët, doli qartë se ata informohen për çdo aktivitet që lidhet me programin bachelor në “Shkenca Politike” dhe që studentët janë të informuar</p>

	<p>për çdo problematikë që mund të lidhet me programin e studimit.</p> <p><i>(Evidenca Nr.6 Rregullore e NJSBC UAMD;</i></p> <p><i>Evidencë 25. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 2021-2022; Evidenca 52. Kodi i Etikës UAMD).</i></p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ gjykon se Departamenti i Shkencave Politike dhe Fakulteti i Shkencave Politike Juridike bazuar në rezultatet e vlerësimit, angazhohet në mënyrë të vazhdueshme për përmirësime në ndryshime të pjesshme të kurrikulës të programit të studimit, përtëritje të stafit akademik, rritje të bashkëpunimit me institucione të tjera, ndryshimeve rrënjësore për riorganizimin e këtij programi studimi në 2023.</p> <p><i>(Evidencë 25. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 2021-2022; Evidencë 45. Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore dhe financiare për vitin 2020-2021).</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Nga analizat dhe raportet vjetore të Departamentit të Shkencave Politike dhe Fakultetit të Shkencave Politike Juridike, GVJ gjykon se ato vlerësojnë ecurinë e strategjive për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë dhe marrin masat e nevojshme për përmirësime të mëtejshme. Konkretisht projektet e bashkëpunimit me institucionet homologe brenda e jashtë vendit i shërbejnë këtij qëllimi, sikurse edhe prioritetit të ndërkombëtarizimit të shpallur nga UAMD.</p> <p><i>(Evidencë 25. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 2021-2022; Evidencë 45. Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore dhe financiare për vitin 2020-2021).</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Politike organizon takime informuese për ndryshimet e ndodhura me personelin akademik dhe studentët. Ky është hapi i parë për rritjen e ndërgjegjësimin të tyre për t'u mobilizuar në rritjen e cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>(Evidencë 25. Raporti vjetor për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë 2021-2022; Evidencë 45. Raporti vjetor i veprimtarisë mësimore, kërkimore shkencore dhe financiare për vitin 2020-2021).</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vlerëson se politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit përfshijnë të gjithë aktorët e interesuar, strukturat, stafet akademike dhe studentët e bashkëpunëtorët e jashtëm. Gjetjet e vlerësimeve diskutohen në takime dhe workshope të organizuara në UAMD, me synim krijimin e kulturës së brendshme të cilësisë. <u>Megjithatë,</u></p>

	<i>raportet e vlerësimit janë ende të pa publikuara në faqen online të UAMD, veçanërisht tek rubrika Transparenca.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkenca Politike” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti ‘Aleksandër Moisiu’ Durrës - UAMD”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion. Së fundmi, avancimi në vitin akademik 2023-2024 me diplomë të dyfishtë Bachelori në Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomaci me Universitetin e Gjenovës, Itali, përforcojnë ekspertizën thelbësore të fushës së marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomaci.
2. UAMD dhe Fakulteti i Shkencave Politike Juridike kanë hartuar dhe zbatojnë një kuadër rregullator si statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor në fuqi dhe ato zbatohen për të garantuar standardet shtetërore të cilësisë.
3. Programi i studimit mundëson pjesëmarrjen e stafit akademik, ndihmës akademik, studentët dhe bashkëpunëtorët të angazhohen në garantimin e cilësisë. UAMD ka një system të menaxhimit të informacionit përmes sistemit online si Pitagora, etj.
4. Ekziston një kornizë për përfshirjen e studentëve në nivele të ndryshme të punës së institucionit, duke përfshirë edhe këtë program studimi, përmes përfaqësimit të tyre në strukturat vendimarrëse dhe tërheqjes së vlerësimeve me pyetësorë periodikë në fund të çdo semestri, që të mundësojnë sigurimin e cilësisë së programit të studimit.
5. Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe cilësore pasi ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit të studimit.
6. Stafi akademik është i familjarizuar me përdorimin e metodave të ndryshme të mësimdhënies dhe të nxënies. Përveç formave tradicionale të mësimdhënies dhe mësimnxënies nëpërmjet leksioneve, transmetimi i dijeve e njohurive bëhet edhe nëpërmjet seminareve, detyrave të kursit, orëve të hapura dhe praktikave profesionale. Megjithatë, mjetet si për mësimdhënien si videoprojektorë e kompjutera mund të zgjerohen.
7. Institucioni ka hartuar procedurë të qartë të detyrimeve të studentit me rregullore e struktura të detajuara deri për punimin e diplomës.
8. Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit.
9. UAMD dhe Departamenti i Shkencave Politike për formimin praktik të studentëve sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit kanë nënshkruar një sërë marrëveshesh me institucione publike, biznese dhe OSHC.
10. Departamenti i Shkencave Politike referon një literaturë të pasur tek studentët për të realizuar programin e studimit, po më e shumta në formën e leksioneve të përgatitura nga pedagogët e të printuara për studentët. Mungojnë tekstet bazë në gjuhën shqipe, ndonëse



ka platforma online, të pëlqyeshme, si për stafet akademike edhe për studentët. Aksesimi në to është i njëjtë për të gjithë, si në mjediset e brendshme të UAMD, ashtu dhe në ato të jashtme të kampusit të ri universitar.

11. Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.
12. Si një institucion që mbështetet nga buxheti i shtetit, UAMD garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.
13. UAMD dhe Departamenti i Shkencave Politike vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënies dhe mundësitë e punësimit.
14. Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të mësimdhënies sipas standardeve shtetërore.
15. Për studentët me nevoja të veçanta, apo grupet vulnerable ofrohen bursa që mbulojnë deri në 100% të tarifës së studimit. Po ashtu edhe për studentët ekselence.

Pika të dobta

1. Departamenti i Shkencave Politike në Fakultetin e Shkencave Politike Juridike të UAMD ofron programin e studimit Bachelor në Shkenca Politike në përputhje me misionin, qëllimin e tij, me strategjinë e zhvillimit dhe vlerat kombëtare. Megjithatë sipas ISCED, klasifikimit ndërkombëtar të fushave të edukimit, Shkencat Politike aktualisht nuk ndodhen në të njëjtin klasifikim me ato Juridike, të parat i takojnë Kategorisë 3. Shkenca Sociale, të dytat Kategorisë 4. Administrim Biznesi dhe Jurisprudencë. UAMD mund ta rishikojë organizimin e Fakultetit. **Standardi I.1, Kriteri 5.**
2. Biblioteka nuk është përditësuar me tekste të reja në mbështetje të mësimdhënies që nga viti 2016. **Standardi IV.3, Kriteri 1, 8.**
3. Mungesa e transportit publik të shpeshtë gjatë orarit të studimit pasi zona ku ndodhet kampusi i ri i universitetit është pa një popullsi residenciale, por e pështatshme si kampus studentët. **Standardi IV.2, Kriteri 1.**
4. Pavarësisht kushteve të kënaqshme që ofron godina e UAMD, dhe sipërfaqeve të lira në mjedisin përreth, në UAMD mungojnë mjediset sportive dhe argëtuese për studentët. **Standardi IV.2, Kriteri 1.**
5. Leksionet e përkthyer nga pedagogët zëvendësojnë literaturën e detyrueshme apo dhe atë plotësuese, por në disa raste ato nuk disponohen në Bibliotekë që të jenë njëloj të aksesueshme për të gjithë studentët. **Standardi IV.3, Kriteri 1.**

Rekomandime

1. Fakulteti të riorganizohet që Shkencat Politike të jenë bashkë me Shkencat Sociale, sipas klasifikimit ndërkombëtar ISCED. **Standardi I.1, Kriteri 5.**
2. Me avancimin nga Departamenti i Shkencave Politike në vitin akademik 2023-2024 me diplomë të dyfishtë Bachelori në Shkenca Ndërkombëtare dhe Diplomaci me Universitetin e Gjenovës, ka nevojë që të përforcohet ekspertiza thelbësore me sfat akademik në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë sipas përvojave evropiane.
3. Një sugjerim nga bisedat me stafet akademike në UAMD ishte që afati prej 10 ditësh për rekrutimin e stafit joefektiv të rritet. **Standardi IV.1, Kriteri 4.**
4. Departamenti i Shkencave Politike të shtojë literaturën e nevojshme fizike të përditësuar në bibliotekën e tij në mbështetje të mësimdhënies, pasi ka munguar furnizimi me tekste të reja pas vitit 2016. **Standardi IV.3, Kriteri 1, 8.**
5. Leksionet e përkthyer nga pedagogët që zëvendësojnë literaturën e detyrueshme apo dhe atë plotësuese, të disponohen në Bibliotekë që të jenë njëloj të aksesueshme për të gjithë studentët. **Standardi IV.3, Kriteri 1.**
6. UAMD të investojë në transportin publik të shpeshtë, mjediset sportive dhe argëtuese për studentët. **Standardi IV.2, Kriteri 1.**

Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program in "Political Science" offered by the Institution of Higher Education "Aleksandër Moisiu" Durrës University - UAMD

Strengths and Affirmations

1. The study program is in accordance with the academic field of the main and basic unit responsible for the study program in the institution. Finally, the advancement in the academic year 2023-2024 with the double degree Bachelor in International Sciences and Diplomacy with the University of Genoa, Italy, reinforce the essential expertise of the field of international relations and diplomacy.
2. UAMD and the Faculty of Political and Legal Sciences have drafted and implement a regulatory framework such as its statute and other regulatory acts, in full compliance with the legal framework in force and they are implemented to guarantee state quality standards.
3. The study program enables the participation of academic staff, academic assistants, students and collaborators to engage in quality assurance. UAMD has an information management system through an online system such as Pythagoras, etc.
4. There is a framework for the involvement of students at different levels of the institution's work, including this study program, through their representation in the decision-making structures and the withdrawal of evaluations with periodic questionnaires at the end of each semester, to enable the provision of the quality of the study program.



5. The academic personnel covering the study program meet the quantitative and qualitative standards as they have the appropriate and special academic qualification in accordance with the field of the study program.
6. The academic staff is familiar with the use of different teaching and learning methods. In addition to the traditional forms of teaching and learning through lectures, the transmission of knowledge is also done through seminars, course assignments, open classes and professional practices. However, teaching aids such as video projectors and computers can be expanded.
7. The institution has drawn up a clear procedure of the student's obligations with detailed regulations and structures up to the thesis of the diploma.
8. The institution of higher education makes available learning environments and suitable infrastructure for the realization of the teaching process of the study program.
9. UAMD and the Department of Political Sciences for the practical training of students according to the nature and field of the study program have signed a series of agreements with public institutions, businesses and CSOs.
10. The Department of Political Sciences refers a rich literature to students to carry out the study program, the most in the form of lectures prepared by lecturers and printed for students. There is a lack of basic texts in the Albanian language, although there are online platforms, suitable for both academic staff and students. Access to them is the same for everyone, both in the internal environments of UAMD and in the external ones of the new university campus.
11. The higher education institution has an internal institutional management system and makes it available for administration, information and monitoring of academic, financial and administrative activity for the study program.
12. As an institution that is supported by the state budget, UAMD guarantees the funding and financial support necessary for the realization of the teaching-research process, the smooth running of the study program and the support of students.
13. UAMD and the Department of Political Science make available to students complete and detailed information on the educational objectives, structure, organization, content of the study program, expected learning outcomes and employment opportunities.
14. UAMD and the Department of Political Science make available to students complete and detailed information on the educational objectives, structure, organization, content of the study program, expected learning outcomes and employment opportunities.
15. The higher education institution follows a clear policy for guaranteeing and promoting the quality of teaching and draws up special guidelines for the development of teaching according to state standards.
16. For students with special needs or vulnerable groups, scholarships covering up to 100% of the study fee are offered. Likewise for excellence students.

Weaknesses

1. The Department of Political Sciences at the Faculty of Political and Legal Sciences of UAMD offers the Bachelor of Political Science study program in accordance with its mission, purpose, development strategy and national values. However, according to ISCED, the international classification of education fields, Political Sciences are currently not in the same classification as Law, the former belong to Category 3. Social Sciences, the latter to Category 4. Business

Administration and Jurisprudence. UAMD may review the organization of the Faculty. **Standard I.1, Criterion 5.**

2. The library has not been updated with new texts to support teaching since 2016. **Standard IV.3, Criterion 1, 8.**

3. Lack of frequent public transport during study hours as the area where the new university campus is located is without a residential population, but suitable as a student campus. **Standard IV.2, Criterion 1.**

4. Despite the satisfactory conditions offered by the UAMD building, and the free surfaces in the surrounding environment, UAMD lacks sports and entertainment facilities for students. **Standard IV.2, Criterion 1.**

5. Lectures translated by lecturers replace mandatory or supplementary literature, but in some cases they are not available in the Library to be equally accessible to all students. **Standard IV.3, Criterion 1.**

Recommendation

1. The Faculty should be reorganized so that Political Sciences are together with Social Sciences, according to the international ISCED classification. **Standard I.1, Criterion 5.**

2. With the advancement from the Department of Political Sciences in the academic year 2023-2024 with a double degree Bachelor in International Sciences and Diplomacy with the University of Genoa, there is a need to strengthen essential expertise with academic skills in the field of international relations and diplomacy according to European experiences .

3. One suggestion from conversations with academic staff at UAMD was that the 10-day deadline for recruiting ineffective staff be increased. **Standard IV.1, Criterion 4.**

4. The Department of Political Science to add the necessary up-to-date physical literature to its library in support of teaching, as there has been a lack of supply of new texts after 2016. **Standard IV.3, Criterion 1, 8.**

5. Lectures translated by lecturers that replace mandatory or supplementary literature should be available in the Library so that they are equally accessible to all students. **Standard IV.3, Criterion 1.**

6. UAMD to invest in frequent public transportation, sports and entertainment facilities for students. **Standard IV.2, Criterion 1.**



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA , LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X